



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21/2021 regjistër (JR)
Datë 29.04.2021

Nr. 38 i vendimit
Datë 06.12.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 06.12.2021, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit (JR) nr. 21/2021, datë 29.04.2021, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 332, datë 12.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri).

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 332, datë 12.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri) (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë *ex-officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, përcolli pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - i. *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
 - ii. *ka mosdeklarime ndër vite dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat;*
 - iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - iv. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi pranë Komisionit një raport², bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit ka referuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës* për subjektin e rivlerësimit.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për gatitur nga Komisioni i Vlerësimit

¹ Raporti i ILDKPKI - së nr. {***} prot, datë 01.10.2018.

² Deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 07.07.2020 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

të Veprimtarisë Etike për Vlerësimin Profesional bazuar në analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë si dhe nga strukturat e brendshme të Prokurorisë së Përgjithshme.

5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse, siç janë pasqyruar më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 332, datë 12.01.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 332, datë 12.01.2021, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
7. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të përfundimeve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

7.1 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të sakta në deklaratën vetting për kriterin e kontrollit të pasurisë. Pasaktësitë e konstatuara gjatë hetimit lidhur me veprime të kryera nga bashkëshorti i saj, u vlerësuan nga trupi gjyqësor se nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit dhe me veprimtarinë e saj si prokurore, e nuk mund, e as duhet të ndikojnë në vlerësimin e subjektit në këndvështrim të procesit të saj të rivlerësimit. Nga vlerësimi i provave dhe shpjegimeve në raport me deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

7.2 Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, Komisioni e gjen subjektin e rivlerësimit të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

7.3 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Bazuar në raportin e KLP-së, vlerësimi të shpjegimeve të subjektit në raport me dokumentacionin lidhur me denoncimet, trupi gjyqësor nuk vëren rrethana për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore apo të dhëna dhe indicie për subjektin, të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e saj profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “e aftë”. Trupi gjyqësor arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në përfundim, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur:

- a) nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c) nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Nga vlerësimi në tërësi i dosjes së rivlerësimit për subjektin Lindita Male (Ziguri) vlerësohet se ajo nuk ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

III. Shkaqet e ankimit

8. Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 332, datë 12.01.2021, të Komisionit për të tria kriteret e vlerësimit³, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenet 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të aktit “Rekomandim për paraqitje ankimi” nr. prot. {***}, datë 31.03.2021⁴, të tre vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”).
9. Sipas Komisionerit Publik, përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit duket se nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioneri Publik parashton si çështje për gjykim rrethana dhe fakte ligjore të cilat kanë mbetur të paqarta pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës apo i janë kërkuar shpjegime. Këto çështje në vlerësimin e Komisionerit Publik përbëjnë shkaqe ligjore të mjaftueshme për t’iu paraqitur për shqyrtim juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) në referencë të nenit 4, pika 2, nenit 59, pika 1 dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të tre kriterëve të vlerësimit.
10. Shkaqet e ngritura në ankimin e Komisionerit Publik lidhur vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur, janë si më poshtë.

10.1. Lidhur me aktivitetin tregtar të personit të lidhur, z. F. M. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), në periudhën 2005-2007, dhe çështje të lidhura me të, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve në dosjen e Komisionit, si dhe në zbatim të pikës 4, germa “a”, të rekomandimit të ONM-së, vëren se pavarësisht shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, mbetet e paqartë:

- (i) gjendja e investimit në godinën e banimit të ndërtuar në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe shpenzimet dhe burimet e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e këtij investimi;
- (ii) detyrimet e shoqërisë “{***}” ShPK ndaj të tretëve, ku nga kontrata e porosisë e datës 01.11.2006, me palë porositëse z. R. K., rezulton se në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, palës sipërmarrëse, shoqërisë “{***}” ShPK, i është paguar shuma prej 40.000 eurosh (neni 3.2, pika 1 e kësaj kontrate), ndërsa subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet rreth rezultateve të hetimit, deklaroi se: [...] shuma 40.000 euro (dyzet mijë) që përmendet në kontratë, nuk është dorëzuar nga shtetasi R. K.;
- (iii) tërheqja nga kontrata e porosisë së datës 01.11.2006 e z. R. K., si dhe pagesa në vlerën 99.000 euro nëpërmjet transfertës bankare në datën 12.01.2007, në favor të z. F. M. dhe kthimi *cash* i kësaj shume, brenda së njëjtës ditë të z. R. K. duken si veprime të kryera me qëllim krijimin e pasojave jo të vërteta të cilat duhet të vlerësohen nga Kolegji.

Për sa më sipër, Komisioneri Publik çmoi të nevojshme që Kolegji të kryejë një hetim më të plotë për aktivitetin tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, si dhe për konflikte interesi të mundshme të subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si prokuror me palët e sipërcituara.

³ Nga përmbajtja e ankimit, shkaqet e ankimit i referohen vetëm kriterit të vlerësimit të pasurisë.

⁴ Regjistruar në institucionin e Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 31.03.2021.

10.2. Lidhur me huamarrjet në periudhën 1993-1994, të personit të lidhur, z. F. M., Komisioneri Publik, në zbatim të pikës 4, germa “b” e rekomandimit të ONM-së dhe nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstaton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk u mbështetën në prova të plota e, për rrjedhojë, nuk janë shteruese dhe, në këto rrethana, Kolegji duhet të hetojë konkretisht lidhur me:

- (i) çështjet gjyqësore mes huadhënësve⁵ dhe personit të lidhur, z. F. M.;
- (ii) konflikte interesi të mundshme të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror me huadhënësit e bashkëshortit.

10.3. Lidhur me huamarrjen në shumën 5.000 euro nga shtetasi A. Gj., deklaruar si burim për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 68,8 m², Tiranë”, përveç sa konstatuar nga Komisioni për burimin e deklaruar kursime në shumën 3.000 euro⁶, Komisioneri Publik, në zbatim të pikës 4, germa “c” e rekomandimit të ONM-së, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. A. Gj. (dajës së saj), për t’i dhënë asaj huan në shumën 5.000 euro, sa kohë nga aktet e administruara nga Komisioni, duket se z. A. Gj. nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

10.4. Mungesa e një arsytimi për vlerësimin tërësor të kriterëve të rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për çështjet e lartpërmendura, përfshirë mungesën e deklarimit nga personi i lidhur të detyrimeve që rrjedhin si rezultat i zëvendësimit të debitorit G. I. me debitorin e ri, z. F. M.⁷, në marrëdhënien e detyrimit me Agjencinë e Trajtimit të Kredive, arsytimi i Komisionit, mbi bazën e të cilit ka arritur në përfundime për subjektin e rivlerësimit, nuk është i plotë dhe gjithëpërfshirës, nisur nga detyrimi për një vlerësim tërësor të kriterëve të vlerësimit.

- 11.** Në përfundim të ankimit, Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji që, bazuar në nenin F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, të marrë në konsideratë shkaqet e ankimit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave për subjektin e rivlerësimit, të vendosë:
- ndryshimin e vendimit nr. 332, datë 12.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ose:
 - lënien në fuqi të këtij vendimi.

IV. Apeli kundërshtues i subjektit të rivlerësimit

- 12.** Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar apel kundërshtues ndaj ankimit të Komisionerit Publik, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar nga neni 456 i Kodit të Procedurës Civile⁸, bazuar në aktet e administruara në dosje, nga të cilat rezulton se apeli kundërshtues është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 23.04.2021, pra është depozituar ditën e tretë, duke filluar llogaritja e

⁵ Huadhënësit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit identifikohen në listën e huadhënësve të periudhës 1993-1994, e administruar nga ILDKPKI-ja dhe e pasqyruar në raportin e saj (faqe 14), si dhe nga lista e depozituar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur pyetësorit II.

⁶ Shih vendimin e Komisionit në paragrafin 1.11 (faqe 10).

⁷ Shkresa e Agjencisë së Trajtimit të Kredive nr. {***} prot., datë 18.05.2020, drejtuar Komisionit.

⁸ Neni 456 i Kodit të Procedurës parashikon: “Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër. Ankimi kundërshtues duhet t’u njoftohet palëve të tjera në gjykim, sipas rregullave për njoftimin e ankimit”.

afatit nga data 20.04.2021. Në këtë datë, subjekti i rivlerësimit ka marrë dijeni për vendimin e Komisionit nr. {***}, datë 13.04.2021⁹, për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik.

13. Subjekti i rivlerësimit në apelin kundërshtues parashtroi se vendimi nr. 332, datë 12.01.2021, i Komisionit është marrë në zbatim të drejtë të ligjit material dhe procedural. Hetimi i kryer ka qenë i plotë dhe konkluzionet mbështeten në prova dhe në ligjin e zbatueshëm. Aktet e administruara nga Komisioni dhe rrethanat e çështjes nuk paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor. Arsyeja pse e bën këtë apel kundërshtues mbështetet dhe në faktin se në arsyetimin e vendimit nuk përmenden të gjitha aktet e administruara si prova, të cilat hedhin dritë në pastërtinë e tij edhe në kriterin e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të kundërshtimeve, për secilin shkak ankimor, depozitoi dokumentacionin shkresor përkatës¹⁰.
14. Në lidhje me çeljen e hetimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit u shpreh se rihetimi nuk do të ndikonte në ndryshimin e konkluzioneve se ai ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Në përfundim, duke i vlerësuar shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik si të pabazuara në fakte dhe prova, të tilla që nuk mund të sjellin cenimin e këtij vendimi, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 332, datë 12.01.2021, të Komisionit.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

⁹ Vendimi i Komisionit për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik i është përcjellë subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 14.04.2021. Këtë shkresë subjekti e ka marrë në dorëzim në datën 20.04.2021, sipas shënimit në dokumentin origjinal postar.

¹⁰ Dokumentacioni i depozituar bashkëlidhur apelit kundërshtues sipas shkaqeve të ankimit: **1.** Për shkakun e parë ka depozituar kopje të dosjes së legalizimit të objektit në rrugën “{***}”, Tiranë. **2.** Për shkakun e dytë: (i) e-mail i datës 17.04.2021 drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet (kancelaria) dhe Zyrës Përmbartimore Përmet për kërkim informacioni si dhe vendime dhe vërtetime të dërguara nga këto dy institucione; (ii) e-mail drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet më datë 22.04.2021 dhe shkrea nr. {***} prot., datë 22.04.2021, e dërguar nga prokuroria; **3.** Për shkakun e tretë: (i) dokumentacion nga ISHSH Tiranë, mbi periudhat e punësimit të A. dhe B. Gj. me vulë të njomë, dorëzuar në Komision me nr. {***} prot, datë 24.10.2020; (ii) akt ekspertimi kontabël dorëzuar në Komision me nr. {***} prot, datë 24.10.2020; (iii) të dhëna të marra me e-mail nga A. Gj. datë 30.11.2020; (iv) pasaportë dhe certifikate natyralizimi për M. Gj.; **4.** Për shkakun e katërt: (i) Vendim nr. 123, datë 29.03.2002 i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet (për zëvendësim debitori) dhe (ii) Urdhër Ekzekutimi, Vendimi nr. {***}, datë 19.03.2003, i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.

b) Legjitimimi i ankuesit

16. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor 15-ditor¹¹ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

17. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit nr. 332, datë 12.01.2021, si dhe apelit kundërshtues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ndaj ankimit të Komisionerit Publik, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 06.10.2021, 20.10.2021, 26.10.2021, 18.11.2021, 02.12.2021, 06.12.2021, në prani të palëve dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, avokatit Xheraldo Gjergji.

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me çeljen e hetimit gjyqësor me kërkesë të Komisionerit Publik, si dhe vlerësimi i provave të administruara nga Kolegji pas mbylljes së hetimit gjyqësor

18. Në seancën gjyqësore të datës 20.10.2021¹², Komisioneri Publik, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit dhe kërkesës për çelje të hetimit gjyqësor, parashtroi se për hetimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, me administrator z. F. M., në periudhën 2005-2007, vlerësonte si të nevojshëm kërkimin e informacionit nga:
- (i) shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, lidhur me investitorin e godinës së banimit në rrugën “{***}”, Tiranë dhe përfituesin e të ardhurave të gjeneruara nga shitja e këtyre pasurive;
 - (ii) shoqëria “{***}” ShPK dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës nëse shtetasi R. K. ka në posedim pasuri të paluajtshme në godinën e banimit, në rrugën “{***}”, Tiranë;
 - (iii) Dhoma Kombëtare e Noterëve lidhur me kontrata të mundshme sipërmarrjeje/shitjeje, të lidhura nga bashkëshorti i subjektit, si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 2005-2013;

¹¹ Nga aktet e administruara në dosje, rezultojnë se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.03.2021, i ka njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë vendimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri). Ky njoftim është regjistruar në Institucionin e Komisionerëve Publikë me nr. {***} prot., datë 30.03.2021. Ankimi i Komisionerit Publik nr. {***} prot., datë 13.04.2021, është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 13.04.2021, që rezultojnë të jetë dita e 14 e afatit ligjor 15-ditor, brenda të cilit mund të ushtrohet e drejta e ankimit.

¹² Seanca e parë gjyqësore, e planifikuar për t'u zhvilluar në datën 06.10.2021, ora 10:15, u shtynga trupi gjykues për mosparaqitjen e Komisionerit Publik, për shkak të përligjor, bazuar në nenin 175 të Kodit të Procedurës Civile.

- (iv) OTP Bank, nëse shoqëria tregtare “{***}” ShPK ka aplikuar për kredi bankare pranë kësaj banke me qëllim investimin në një godinë banimi dhe shërbimi, në periudhën 2005-2007;
- (v) organi i prokurorisë për konflikte interesi të mundshme të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror me shoqëritë “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe shtetasin R. K..

18.1 Për huamarrjet e personit të lidhur, z. F. M., në periudhën 1993-1994, sipas Komisionerit Publik, Kolegji duhet të hetojë për ekzistencën e çështjeve gjyqësore mes huadhënësve dhe personit të lidhur, si dhe duhet të marrë informacion nga organi i prokurorisë nëse subjekti i rivlerësimit ka hetuar ose ka kryer veprime procedurale në çështje që lidhen me palët huadhënëse për të provuar konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror me huadhënësit e personit të lidhur.

18.2 Për huamarrjen në shumën 5.000 euro, deklaruar si burim krijimi për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 68,8 m², Tiranë”, konkluzionet e arritura nga Komisioni, sipas Komisionerit Publik, nuk përputhen me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, pasi nga verifikimi i zërave të analizës financiare në aktekspertimin e depozituar nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, vëren se shpenzimet e jetesës nuk janë llogaritur në përputhje me përbërjen familjare të z. A. Gj., si edhe për vitin 2007, këto shpenzime nuk janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI/INSTAT. Kjo situatë duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, në varësi dhe të rezultateve të hetimit të kërkuar nëpërmjet ankimit.

18.3 Subjekti i rivlerësimit gjatë seancës parashtroi kundërshtimet e tij lidhur me çështjet e shtruarra për gjykim nga ana e Komisionerit Publik, si dhe e la në vlerësimin e Kolegjit pranimin ose jo të kërkesës së Komisionerit Publik për riçeljen e hetimit gjyqësor, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim, në rast të çeljes së hetimit. Në funksion të prapësimit të shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa prova të reja¹³ bashkë me aktet e administruara nga Komisioni, por të sjella në formën e kërkuar nga ligji.

¹³ *Prova të cilësuaratë reja nga subjekti i rivlerësimit:*

- i. *Shkresa nr. {***} prot., datë 15.04.2021, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtuar z. F. M. për dërgimin e praktikës së legalizimit të shtesës në objektin e ndërtuar në rrugën “{***}”, Tiranë.*
- ii. *Shkresat “Kthim përgjigje” me nr. {***} prot., datë 29.09.2021, nr. {***} prot., datë 4.10.2021; nr. {***} prot., datë 18.10.2021, nr. {***} prot., datë 19.10.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në përgjigje të kërkesave për informacion të subjektit të rivlerësimit.*
- iii. *Shkresa nr. {***} prot., datë 18.10.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përgjigje të kërkesës për informacion të subjektit të rivlerësimit.*
- iv. *Gjashtë vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet: nr. {***}, datë 16.11.2001, me paditës A. C.; nr. {***}, datë 13.12.1994, me paditës D. R.; nr. {***}, datë 13.04.1995, me paditës Ll. Th.; nr. {***}, datë 05.06.1995, me paditës Th. J.; nr. {***}, datë 04.08.1995, me paditës J. Z. dhe L. N.; nr. {***}, datë 05.12.1995, me paditës të kundërtëpaditur F. L. dhe Q. Q.*
- v. *Tri vërtetime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, lëshuar më datë 21.04.2021, me nr. {***}, nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot.*
- vi. *Shkresa nr. {***} prot./ {***}, datë 22.04.2021, me lëndë “Dërgohet informacion”, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, drejtuar subjektit të rivlerësimit.*

18.4 Në përfundim të kësaj seance, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të shqyrtimit të çështjes, pasi vlerësoi kërkesat për informacion të Komisionerit Publik dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të çelë hetimin gjyqësor, si dhe mori në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, të cituara në paragrafin 18.3.

19. Në seancën gjyqësore të datës 26.10.2021, trupi gjykues, pasi analizoi kërkesat për hetim të Komisionerit Publik, aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në seancën e datës 20.10.2021, si dhe pasi vlerësoi edhe kryesisht, si të nevojshme, kryerjen e disa veprimeve hetimore, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi zhvillimin e hetimit në lidhje me secilin shkak ankimor, si në vijim.

1. Për aktivitetin tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, me ortak të vetëm dhe administrator z. F. M., u kërkua informacion nga:

a) shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, lidhur me investitorin/investitorët e godinës së banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe përfituesin e të ardhurave të gjeneruara nga shitja e pasurive të kësaj godine;

b) OTP - Bank ShA, nëse shoqëria tregtare “{***}” ShPK., me administrator z. F. M., apo vetë z. F. M. individualisht, ka aplikuar për kredi bankare pranë kësaj banke në periudhën 2005-2007 dhe, nëse po, cili ka qenë qëllimi i kredisë sipas kërkesës;

c) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nëse subjekti i rivlerësimit ka trajtuar çështje penale apo material kallëzues ndaj shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, apo përfaqësuesve të tyre ligjorë, për periudhën 2005-2006;

ç) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështje civile me palë paditëse z. R. K. dhe palë të paditur z. F. M., të regjistruar në këtë gjykatë nga viti 2005 e në vijim, dhe, nëse po, të jepet informacion dhe për statusin e tyre.

2. Për huamarrjet e personit të lidhur, z. F. M., për periudhën 1993-1994, u kërkua informacion nga:

a) Agjencia e Trajtimit të Kredive lidhur me çeljen dhe ecurinë e procedurës së ekzekutimit të Urdhrit të Ekzekutimit, me vendimin nr. {***}, datë 19.03.2003, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, në favor të kreditorit Agjencia e Trajtimit të Kredive Tiranë, kundër debitorit F.M.;

vii. *Tri vërtetime të Zyrës Përmbartimore Përmet: nr. {***} prot., datë 20.04.2021; nr. {***} prot., dhe nr. {***} prot., të lëshuara më datë 22.04.2021.*

viii. *Shkresat “Kthim përgjigje” të Agjencisë së Trajtimit të Kredive me nr. {***} prot., datë 27.09.2021 dhe nr. {***} prot., datë 04.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit në përgjigje të kërkesave për informacion për çështjen e zëvendësimit të debitorit.*

ix. *Certifikatë natyralizimi në emër të M. L. (Gj.), lëshuar më 19.08.2008 dhe pasaportë e saj lëshuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më datë 30.01.2011 (të përkthyer dhe të noterizuara).*

b) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nëse subjekti i rivlerësimit ka trajtuar çështje penale apo material kallëzues ndaj shtetasve D. R. R. dhe Ll. N. Th.¹⁴, si huadhënës të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

3. Për huamarrjen në shumën 5.000 euro, marrë nga personi tjetër i lidhur, z. A. Gj., u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile lidhur me gjendjen familjare të personit tjetër të lidhur, z. A. Gj., për vitet 2005-2008.

20. Në seancën gjyqësore të datës 18.11.2021, trupi gjykues administroi përgjigjet e dërguara nga institucionet dhe subjektet¹⁵, në zbatim të kërkesave për informacion që Kolegji i përcolli me shkresat zyrtare të datës 28.10.2021¹⁶, të cilat iu përcollën paraprakisht Komisionerit Publik, subjektit të rivlerësimit, si dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

20.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të vendimit të trupit gjykues për zhvillim hetimesh, paraqiti për administrim dhe shqyrtim nga Kolegji dokumentacion¹⁷ provues shtesë, në lidhje me

¹⁴ Me kërkesë të Komisionerit Publik, të parashtruar gjatë seancës, pasi konstatoi se për këta dy shtetas, edhe pse subjekti i rivlerësimi kishte depozituar vendimet civile të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, me të cilat ishin pranuar paditë e tyre me objekt “kthim shume”, kundër të paditurit F. M., nuk ishin përfshirë në kërkesën e tij për informacion të datës 25.09.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti u shpreh në seancë se kjo kishte ndodhur për shkak mosrakordimi nga ana e tij.

¹⁵ Kthim përgjigje nga: (i) shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, datë 12.11.2021; (ii) Banka OTP Albania ShA, nr. prot. {***}, datë 02.11.2021; (iii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***} prot., datë 15.11.2021; (iv) Agjencia e Trajtimit të Kredive, nr. {***} prot., datë 05.11.2021; (v) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nr. {***} prot., datë 09.11.2021; (vi) Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***} prot {***}, datë 17.11.2021.

¹⁶ Kërkesat për informacion: nr. {***} regj., drejtuar shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK; nr. {***} regj., drejtuar Bankës OTP Albania ShA; nr. {***} regj., drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; nr. {***} regj., drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. {***} regj., drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Kredive, nr. {***} regj., drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile; nr. {***} regj., drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

¹⁷ i) Deklaratë noteriale, nr. repertori {***}, nr. koleksioni {***}, datë 04.11.2021, e shtetasve G. D. dhe E. G. B. (D.).

ii) Deklaratë noteriale, nr. repertori {***}, nr. koleksionil {***}, datë 05.11.2021, e shtetasit E. A..

iii) Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar të subjektit, shoqëri aksionare banka OTP Albania, printuar nga e-Albania, datë 04.11.2021, vulosur elektronikisht nga QKB, datë 04.11.2021, ora 16:00.

iv) Shkresë nr. {***} prot., datë 02.11.2021, e Qendrës Kombëtare të Biznesit për vënie në dispozicion dhe vërtetim të kopjes në letër të dokumentit elektronik, lidhur me tri akte: vendim për regjistrimin si person juridik nr. {***}, datë 12.12.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës Popullore SHA, z. E. L.; akt themelimi dhe statuti i shoqërisë tregtare “Banka Popullore” ShA, datë 12.11.2003.

v) Kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 08.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar subjektit të rivlerësimit për vënie në dispozicion të kopjeve të nxjerrra nga sistemi elektronik i vendimeve gjyqësore në emër të shtetasve G. D., E. D. dhe shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK; kërkesë drejtuar gjykatës dhe dëftesë postare, datë 26.10.2021.

vi) Kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 29.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të kërkesës për informacion, datë 26.10.2021, lidhur me shtetasit D. R. dhe Ll. Th. dhe dëftesapostare.

vii) Kthim përgjigje nr. {***} prot./ {***}, datë 05.11.2021 dhe nr. {***} prot./ {***}, datë 01.11.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, drejtuar subjektit të rivlerësimit për dërgim

të gjitha çështjet e shtruara për gjykim nga Komisioneri Publik në ankim, si dhe në parashtrimet e tij gjatë gjykimit.

20.2 Trupi gjykues vendosi të lejojë marrjen në cilësinë e provave të përgjigjeve të ardhura pranë Kolegjit nga institucionet dhe subjektet të cilave Kolegji u ishte drejtuar me kërkesa për informacion, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në këtë seancë.

20.3 Komisioneri Publik parashtrroi me shkrim dhe verbalisht qëndrimin e tij, pasi vlerësoi aktet e përcjella nga Kolegji dhe aktet e depozituara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit në raport me shkaqet e ankimit.

20.4 Subjekti, gjatë seancës, u shpreh verbalisht se dokumentacioni i depozituar në këtë seancë përbënte provë për të gjitha çështjet e ngritura në ankimin e Komisionerit Publik, duke cituar për çdo shkak ankimor të ngritur nga Komisioneri Publik, edhe dokumentacionin përkatës provues që, në vlerësimin e tij, rrëzonte secilin prej shkaqeve ankimore.

21. Pas mbylljes së hetimit gjyqësor, Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit parashtruan konkluzionet përfundimtare lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

21.1 Komisioneri Publik, në konkluzionet përfundimtare vlerësoi se, bazuar në parashtrimet e tij, rekomandimin e ONM-së, në mbështetje të provave të administruara në dosjen e Komisionit, provave të administruara gjatë hetimit gjyqësor në Kolegj, parashtrimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit, dhe në vlerësimin tërësor të çështjes në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, i kërkoi përfundimisht Kolegjit të vendosë ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 332, datë 12.01.2021 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

21.2 Subjekti i rivlerësimit, përkundrejt shkaqeve të ankimit, të formuluar në ankim, si dhe parashtrimeve të Komisionerit Publik gjatë gjykimit në Kolegj, u shpreh se nga tërësia e hetimeve të kryera, del qartësisht se nuk ka asnjë indicie për përfshirjen në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën e tij si prokuror, se ka shpjeguar dhe provuar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe në asnjë rast nuk është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi. Për këto arsye, si dhe duke qenë një figurë e përshtatshme për drejtësinë që gëzon profesionalizëm, vlerëson se nuk vërtetohen, në asnjë rast, shkaqet kushtetuese për dhënien ndaj saj të masës disiplinore të shkarkimit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

informacion për shtetasit D. R. dhe Ll. Th.; kërkesa për informacion e datës 26.10.2021, drejtuar organit të prokurorisë, si dhe dëftesapostare.

viii) *Kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.11.2021, e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë drejtuar M. Gj., kërkesë e M. Gj. dhe dëftesapostare.*

ix) *Nevoja për të dhëna, e-mail i datës 06.11.2021, nga adresa {***}, drejtuar M. Gj.; kthim përgjigje, datë 15.11.2021, nga adresa: {***}. Vërtetim dhe verifikim nr. {***} rep., datë 16.11.2021 nga noteri R. M..*

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit të lidhura me të

22. Në lidhje me shkakun e ankimit për aktivitetin tregtar të personit të lidhur, z. F. M., në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të, trupi gjykues konstaton si më poshtë.

Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me aktivitetin tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, me përfaqësues z. F. M., ka arritur në përfundimin se: [...] 4.30 Lidhur me veprimtarinë tregtare të personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit), trupi gjykues krijoi bindjen se ajo nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit dhe as me ushtrimin e detyrës së tij. Bashkëshorti i subjektit ka vepruar si tregtar në mënyrë të pavarur nga subjekti i rivlerësimit. Veprimet e kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, të cilat, për më tepër, nuk kanë sjellë as përfitime në ekonominë e përbashkët familjare, nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk plotëson kushtet për ta konsideruar mosdeklarimin e transaksionit si fshehje të pasurisë, në kuptim të procesit të rivlerësimit, si dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në arritjen e këtij përfundimi, është bazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetjeve të ngritura nga Komisioni¹⁸, dokumentacionin, si dhe shpjegimet e subjektit pasi Komisioni i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultave të hetimit për çështjet që pasqyrohen në pikën 4.26/i/ii/iii të vendimit të Komisionit.

23. Trupi gjykues, në lidhje me shkakun ankimor për aktivitetin e shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 2005-2007, konstaton se Komisioneri Publik brenda tij ka parashtruar tri çështje, të cilat lidhen me ndërtimin e godinës së banimit dhe shërbimit në rrugën “{***}” Tiranë¹⁹ dhe që kanë të bëjnë me:
1. investimin, shpenzimet që mund të ketë kryer shoqëria “{***}” ShPK në ndërtimin e kësaj godine, si dhe të ardhurat që mund të ketë përfituar nga shitja e pasurive në këtë godinë;
 2. detyrimet e kësaj shoqërie ndaj të tretëve;
 3. konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit me palët e përfshira në marrëdhënien me shoqërinë “{***}” ShPK, me administrator bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, këto tri pretendime u morën në shqyrtim dhe u trajtuan nga trupi gjykues në veçanti si më poshtë.

23.1 Komisioneri Publik si në ankim ashtu dhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, pretendoi se faktet që lidhen investitorin e godinës së banimit të ndërguar në rrugën “{***}” Tiranë, burimin e të ardhurave dhe shpenzimet e kryera si dhe përfituesin e të ardhurave nga shitja e pasurive të kësaj godine, kanë mbetur të pasqaruara, në kushtet kur në datën 07.07.2005 mes z. F. M., si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e investitorit dhe shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori z. G. D., është nënshkruar kontrata e bashkëpunimit për

¹⁸ Sipas pyetësorit II.

¹⁹ Leja e ndërtimit nr. {***}, datë 20.10.2004, lëshuar në emërtë shoqërisë ndërtuese “{***}”, miratuar me vendimin e KRRT nr. {***}, datë 28.05.2004.

sipërmarrje ndërtimi nr. {***} rep, nr. {***} kol, datë 07.07.2005²⁰, me objekt financimin e ndërtimit të kësaj godine nga shoqëria “{***}” ShPK, si investitor.

23.1.1 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me aktivitetin e bashkëshortit në ndërtimin e godinës së banimit në rrugën “{***}”, gjatë gjykimit në Kolegj, parashitri se shkresa nr. {***} prot., datë 08.10.2020²¹, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “ASHK”), drejtuar z. F. M., përmban të dhëna të plota për ndërtuesin, investitorin, si dhe përfituesin e lejes së legalizimit të godinës së banimit të ndërtuar në rrugën “{***}”, sipas lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 28.05.2004, miratuar në favor të subjektit ndërtues “{***}” ShPK. Nga përmbajtja e kësaj shkrese, rezulton se shoqëria “{***}” ShPK i ka kaluar të drejtat reale dhe pasurore shoqërisë “{***}” ShPK, me përfaqësuese E. D., për të kryer procedurat e legalizimit të shtesës në këtë godinë. Shoqëria “{***}” ShPK ka aplikuar për leje legalizimi në vitet 2006²², 2014 dhe 2015 dhe, në përfundim të procedurave të legalizimit, në favor të saj është lëshuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 12.06.2018. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, përmbajtja e shkresës nr. {***} prot., datë 08.10.2020, e ASHK-së përforcohet me praktikën e legalizimit të shtesës në këtë objekt, e cila i është përcjellë Komisionit nga ASHK-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 25.10.2020. Përmbajtja e këtyre dokumenteve zyrtare, sipas subjektit të rivlerësimit, vërteton deklaratimet e tij para Komisionit se bashkëshorti dhe subjekti i tij tregtar nuk kanë kryer ndërtim me ose pa leje, nuk kanë kryer shpenzime, nuk kanë realizuar të ardhura, si dhe nuk kanë përfituar sipërfaqe ndërtimi apo të kenë pasur ndonjë lloj përfitimi tjetër qoftë si person fizik, apo dhe si shoqëri. Duke mos ushtruar aktivitet tregtar, nuk ka se si të ketë pasur detyrime tatimore ndaj shtetit, fakt i konfirmuar, sipas subjektit, me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë nr. {***} prot., datë 05.06.2020, drejtuar Komisionit, sipas së cilës për shoqërinë “{***}” ShPK, me {***}, nuk disponohen të dhëna tatimore në sistemin C@TS dhe në arkiv²³. Edhe Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.06.2020, drejtuar Komisionit, ka konfirmuar se shtetasi “{***}” figuron të ketë qenë administrator, ortak i vetëm dhe likuidator i shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, e cila aktualisht është me status “e çregjistruar”. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe ka shprehur subjekti në lidhje me aktivitetin tregtar dhe në apelin kundërshtues.

23.1.2 Nga provat e administruara në fashikullin gjyqësor, rezulton se “{***}” si administrator i shoqërisë “{***}” ShPK²⁴, ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi për sipërmarrje ndërtimi nr. {***} rep, nr. {***} kol, datë 07.07.2005, me shoqërinë “{***}” ShPK, në të cilën shoqëria “{***}” ShPK është në cilësinë e investitorit, ndërsa shoqëria “{***}” ShPK është në cilësinë e sipërmarrësit. Objekti i kësaj kontrate ishte ndërtimi i godinës së banimit dhe shërbimit në rrugën “{***}”, Tiranë. Sipas nenit 6 të kësaj kontrate, investitori do të siguronte mjetet monetare nëpërmjet një kredie që do të merret pranë Bankës Popullore dhe do të përmbushte detyrat e përcaktuara në nenin 8 të kësaj kontrate për të siguruar financimin e kostos së ndërtimit dhe realizimin e tij sipas grafikut të financimit të pranuar nga sipërmarrësi, por financimi për ndërtimin

²⁰ Pika 6 e kontratës parashikon: “Financimi bëhet me mjetet e veta financiare të “{***}” ShPK, të kredituara nga Banka Popullore sipas procedurave teknike dhe ekonomike”.

²¹ Dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur pyetësorit II.

²² Leja e legalizimit është lëshuar bazuar në aplikimin nr. {***}, datë 14.11.2006, të depozituar nga znj. E. D., administratore e shoqërisë “{***}” ShPK.

²³ Sipas kopjes së printuar nga sistemi informatik tatimor C@TS, detyrimet në kohë reale, më datë 02.06.2020, për këtë subjekt, janë 0 lekë.

²⁴ Në këtë kontratë, emërtimi i shoqërisë është “{***}” ShPK, por duke iu referuar akteve të administruara në dosje, rezulton se emërtimi i plotë i kësaj shoqërie është “{***}” ShPK, e cila është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me ortak dhe administrator z. F. M., me vendimin nr. {***}, datë 27.04.1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

e këtij objekti nga investitori, shoqëria “{***}” ShPK, sikurse do të trajtohet në vijim, nuk u realizua.

23.1.3 Provat e administruara gjatë hetimit gjyqësor u shqyrtuan dhe u analizuan nga trupi gjykues i Kolegjit lidhur me vlerën provuese të tyre në raport me sqarimin e fakteve, nëse shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, në periudhën 2005-2007, ka investuar, ka kryer shpenzime në godinën e banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, apo ka përfituar të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme të kësaj godine.

23.1.4 Trupit gjykues, pas analizës së akteve të administruara në fashikullin gjyqësor, përfshirë dhe aktet e administruara gjatë hetimit gjyqësor të zhvilluar nga Kolegji, i rezultoi se:

1. Shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, dhe shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, janë investoret e godinës së banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas informacionit të përcjellë në Kolegji nga këto dy shoqëri me shkresat e datës 12.11.2021, i cili është në koherencë dhe në përputhje edhe me përmbajtjen e deklaratës noteriale me nr. repertori {***}, nr. koleksioni {***}, datë 04.11.2021, të dy administratorëve të shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, përkatësisht G. D. dhe E. D., të cilët kanë deklaruar se “{***}”, qoftë si individ apo dhe si shoqëri nuk ka investuar asnjë vlerë monetare dhe as materiale në ndërtimin e objektit në rrugën “{***}”, Tiranë, nuk ka kryer shitje të ambienteve dhe as nuk ka përfituar nga këto shitje. Gjithashtu, edhe dokumentacioni i legalizimit të kësaj godine, i përcjellë në Komision nga ASHK-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 25.11.2021, por që nuk është administruar nga Komisioni²⁵ dhe që është ridepozituar nga subjekti i rivlerësimit me parashtimet e datës 20.10.2021²⁶, provon faktin se dy shoqëritë e sipërcituara janë investoret e kësaj godine.
2. Shoqëria “{***}” ShPK është përfituesja e të ardhurave nga shitja e pasurive në godinën e banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas informacionit të përcjellë në Kolegji nga dy shoqëritë e sipërcituara, me shkresat e datës 12.11.2021, pasi në emër të shoqërisë “{***}” ShPK rezulton se është lëshuar leja e legalizimit nr. {***}, datë 12.06.2018, sipas dokumentacionit të legalizimit të kësaj godine, përcjellë në Komision me shkresën e ASHK-së, të sipërcituar.
3. Shoqëria tregtare “{***}” ShPK dhe shtetasi “{***}” individualisht nuk kanë marrë kredi pranë Bankës OTP Albania ShA (ish-Banka Popullore) sipas informacionit të përcjellë në Kolegji, nga banka OTP Albania me shkresën nr. prot {***}, datë 02.11.2021²⁷. Si rrjedhim, financimi i marrë përsipër nga kjo shoqëri, si investitore, në kontratën e bashkëpunimit për sipërmarrje ndërtimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2005, nuk është realizuar.

23.1.4 Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se shoqëria tregtare “{***}” ShPK, me NIPT {***}, dhe administrator z. F. M., nuk është investitorja e godinës së banimit në rrugën “{***}”, Tiranë dhe as përfituesja e të ardhurave të gjeneruara nga shitja e pasurive të kësaj godine.

²⁵ Shkresa “Kthim përgjigje” e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. {***} prot., datë 25.11.2020 (dokumentacion bashkëlidhur 414 fletë) është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 27.11.2020, dy ditë pas përfundimit të hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, sipas vendimit të trupit gjykues nr. 2, datë 25.11.2020. Në fashikujt nr. 12, nr. 12/1 të dosjes gjyqësore të dërguar nga Komisioni është bërë i njëjti shënim: “i gjithë materiali i qepurnë këtë fashikull ka ardhur pas rezultateve të hetimit dhe nuk është përdorur në hetim”.

²⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 15.04.2021, e ASHK-së, drejtuar z. F. M., për dërgimin e praktikës së plotë të legalizimit të objektit në rrugën “{***}”, Tiranë.

²⁷ Kthim përgjigje për kërkesën për informacion me nr. {***} regj., datë 28.10.2021, dërguar nga Kolegji.

23.2 Lidhur me pretendimin tjetër të ngritur nga Komisioneri Publik se, në kuadrin e aktivitetit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 2005-2007, mbeten të paqarta detyrimet e kësaj shoqërie ndaj të tretëve, referuar kontratës së porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2006, të nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori “{***}”, si sipërmarrës, dhe R. K., si porositës, për ndërtimin dhe shitjen nga sipërmarrësi në favor të porositësit, të dy apartamenteve sipas lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 28.05.2004, për godinën në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues konstaton se:

23.2.1 Sipas Komisionerit Publik, detyrimet e shoqërisë “{***}” ShPK ndaj të tretëve kanë mbetur të paqarta, pasi në datën e lidhjes së kontratës së porosisë, rezulton se shoqërisë i është paguar shuma 40.000 euro (neni 3.2, pika 1 e kontratës); më pas është kryer pagesa në vlerën 99.000 euro nëpërmjet transfertës bankare në datën 12.01.2007 te z. F. M.; kthimi *cash* i kësaj shume, brenda së njëjtës ditë te z. K. dhe tërheqja nga kontrata e z. K.. Të gjitha këto veprime, sipas Komisionerit Publik, duken si veprime të kryera me qëllim krijimin e pasojave jo të vërteta, të cilat duhet të vlerësohen nga Kolegji.

23.2.2 Në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtroi se dhe pse shoqëria “{***}” ShPK nuk ka qenë investitore apo përfituese²⁸ e të ardhurave të gjeneruara nga shitja e pasurive në godinën e banimit, rruga “{***}”, ka qenë palë në kontratën noteriale të porosisë, e cila, si akt shkresor, përbën provë të plotë të përmbajtjes së saj në mungesë të një akti noterial që ta ketë ndryshuar/shfuqizuar. Pretendimi i subjektit se shuma 40.000 euro që përmendet në kontratën noteriale, nuk është dorëzuar nga shtetasi R. K., në vlerësimin e tij mbetet në nivel deklarativ. Si pjesë e aktivitetit tregtar të këtij subjekti juridik, me ortak të vetëm personin e lidhur, nuk është pasqyruar veprimi juridik dhe financiar i kalimit të shumës 99.000 euro nga llogaria personale e shtetasit R. K., palë në kontratën e porosisë në llogarinë personale të personit të lidhur dhe tërheqja e shumës prej tij. Komisioneri Publik konstaton se në këto rrethana juridike dhe fakti, bazuar në aktet shkresore me fuqi të plotë provuese, për sa kohë nuk janë ndryshuar ose shfuqizuar, si dhe në dokumentacionin bankar: (i) personi i lidhur ka përfituar shumën prej 40.000 eurosh me lidhjen e kontratës së porosisë; (ii) personi i lidhur ka kryer veprime në llogari bankare individuale për shumën 99.000 euro; (iii) këto veprime juridike dhe transaksione financiare nuk janë deklaruar nga personi i lidhur/subjekti i rivlerësimit në deklaratat vjetore dhe atë *vetting*, edhe pse në kushtet e mungesës së konfliktit të interesit në kryerjen e funksionit të saj, subjekti i rivlerësimit gjendet në rastet e parashikuara nga pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

23.2.3 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me detyrimet e shoqërisë “{***}” ShPK ndaj të tretëve, gjatë gjykimit në Kolegji, parashtroi se, pas anulimit të kontratës së porosisë të datës 01.11.2006, me iniciativë dhe për arsye personale të porositësit, shtetasit R. K., bashkëshortit të saj, as si individ dhe as si shoqëri nuk i mbeti asnjë lloj detyrimi. Mandatpagesa nr. {***}, datë 12.01.2007, ndërmjet porositësit R. K. dhe shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2016, e z. R. K. konfirmon zgjidhjen e kontratës së porosisë dhe vërteton kthimin e shumës 99.000 euro. Si veprime juridike me karakter civil të kryera brenda vitit (2007), ato nuk kanë sjellë të ardhura apo përfitime për të dhe bashkëshortin, si person i lidhur, dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, nuk ka pasur detyrimin për t’i deklaruar në deklaratën *vetting*. Subjekti, në vlerësimin e tij, ka përmbushur detyrimin ligjor të deklarimit të përvitshëm, duke mos deklaruar diçka që ai dhe bashkëshorti nuk e kanë fituar. Shuma 40.000 euro që përmendet në kontratë, nuk

²⁸ Konstatuar nga Komisioneri Publik në parashtrimet e depozituara në seancën e datës 18.11.2021 (faqe 3-4).

është dorëzuar nga shtetasi R. K., pasi neni 3.2, pika 1 e kontratës së porosisë përcakton qartë se dhënia e shumës 40.000 euro do të pasqyrohet në një mandatpagesë. Gjithashtu, edhe në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2016, me deklarues R. K., thuhet: “kthimi i shumës 99.000 euro”, pra shuma e kredisë bankare dhe jo shuma 40.000 euro që nuk u dha kurrë. Nëse do të ishte ndryshe, nuk do të kishte shpjegim fakti që gjatë gjithë kësaj periudhe, të mos ishte çelur nga porositësi asnjë proces gjyqësor civil për kthimin e shumës 40.000 euro.

23.2.4 Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se palë në kontratën e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2006²⁹, është shoqëria “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, e përfaqësuar nga z. F. M. si administrator i saj dhe z. R. K., në cilësinë e porositësit. Në nenin 3 të kësaj kontrate, është parashikuar që çmimi i kontratës do të paguhet nga porositësi me këste: [...] *kjo shumë do të paguhet nga porositësi: (i) sot në datën e lidhjes së kësaj kontrate nga porositësi, z. R. K., është paguar shuma 40.000 euro, pagesë e cila do të pasqyrohet me mandatpagesë; (ii) pjesa tjetër e detyrimit do të likuidohet në momentin e akordimit të kredisë nga banka në të cilën do të aplikojë për kredi porositësi [...].*

23.2.5 Shuma 40.000 euro, si kësti i parë i çmimit të kontratës, dhe shuma 99.000 euro, e kredituar në datën 12.01.2007, në llogarinë e z. F. M. nga llogaria e z. R. K., me përshkrimin: *blerje apartamenti nga R. K. në favor të “{***}”, administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}” ShPK³⁰*, janë pagesa të kryera për llogari të shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, pasi sipas ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” (në vijim “ligji nr. 7638/1992”), në një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është administratori i shoqërisë, në rastin konkret z. F. M., i cili në ushtrim të kompetencave të tij si administrator, ka hyrë në marrëdhënie me të tretët, pra me z. K., duke vepruar dhe duke marrë përsipër detyrime në emër të tij sipas përcaktimeve të nenit 50³¹ të ligjit nr. 7638/1992. Në vlerësim të këtij parashikimi ligjor, trupi gjykues konkludon se këto pagesa nuk kanë qenë përfituar nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

23.2.6 Trupi gjykues vëren se kontrata e porosisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2006, e nënshkruar mes shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, dhe z. R. K., në cilësinë e porositësit, si një kontratë sipërmarrjeje e cila është lidhur bazuar në nenin 850³² e vijues të Kodit Civil, nuk është zbatuar pasi nuk është realizuar objekti i përcaktuar për ndërtimin dhe shitjen në favor të porositësit të dy apartamenteve në godinën e banimit dhe shërbimit në rrugën “{***}”, Tiranë. Porositësi është tërhequr nga kontrata e porosisë, sikurse parashikon neni 868³³ i Kodit

²⁹ Sipas kontratës, shoqëria “{***}” ShPK: “[...] merr përsipër ndërtimin dhe shitjen në favor të porositësit, dy apartamente, [...] me sipërfaqe 125 m² secili [...]. Po ashtu, palët kanë rënë dakord që porositësi do të blejë apartamentet e mësipërme kundrejt çmimit 900 euro/m² [...] në total prej 225.000 euro”.

³⁰ Kthimpërgjigje nr. {***}, datë 16.10.2020, e Abi Bank, drejtuar Komisionit.

³¹ Neni 50, Administrimi:

“Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve. Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga ana e administratorëve edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë”.

³² Në Kodin Civil, neni 850, parashikohet: “Sipërmarrja është kontrata me të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë), ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë”.

³³ Në Kodin Civil, neni 868, “Zgjidhja e kontratës dhe pasojat juridike”, parashikohet:

“Porositësi mund të tërhiqet nga kontrata, edhe kur ka filluar zbatimin e veprës ose kryerja e shërbimit, me kusht që ta kompensojë sipërmarrësin për shpenzimet e kryera, për punimet e bëra dhe për fitimin e munguar”.

Civil dhe kjo tërheqje është reflektuar në mandatpagesën nr. {***}, datë 12.01.2007, të shoqërisë “{***}” ShPK, nëpërmjet së cilës z. K. i është kthyer shuma 99.000 euro. Në funksion të provueshmërisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit se kontrata e porosisë është anuluar, Kolegji administroi deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2016, të nënshkruar nga z. R. K., i cili deklaroi se: *në muajin janar të vitit 2017, unë e kam zgjidhur kontratën e porosisë me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, duke marrë nga administratori i shoqërisë “{***}”, shumën prej 99.000 eurosh, kjo e shoqëruar me mandatpagesë me nr. {***}, datë 12.01.2007, e nënshkruar nga të dyja palët.*

23.2.7 Kolegji vlerëson se deklaratat noteriale e sipërcituar ka vlerë të posaçme provuese për deklaratimet e z. K., pasi është hartuar dhe nënshkruar disa muaj përpara miratimit dhe hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, që parashikojnë kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016³⁴ dhe, si rrjedhim, shumë muaj përpara fillimit të procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, kjo deklaratë noteriale vërteton faktin që shuma 99.000 euro, në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i tij nuk ishte në posedim të tyre. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se përmbajtja e kësaj deklarate përputhet me deklaratimet në deklaratën noteriale nr. repertori {***}, nr. koleksioni {***}, datë 04.11.2021, të administruar gjatë gjykimit në Kolegj, nëpërmjet së cilës G. D. dhe E. D. deklarojnë se nuk kanë pasur asnjë marrëdhënie juridike ose private me z. R. K., si dhe z. K. nuk ka përfutur nga shitblerja në objektin e banimit dhe shërbimit në rrugën “{***}”, Tiranë.

23.2.8 Në vlerësimin e trupit gjykues, referuar akteve të administruara në dosjen gjyqësore, veprimet financiare të kryera nga shoqëria “{***}” ShPK nuk kanë shërbyer për të krijuar të ardhura, pasuri ose detyrime për personin e lidhur, si dhe për vetë subjektin e rivlerësimit, për të cilat si subjekti i rivlerësimit, ashtu dhe personi i lidhur të mbartin detyrimin për deklarimin e tyre në deklaratat e interesave private periodikë vjetorë, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe në deklaratën *vetting*, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

23.2.9 Lidhur me konstatimin e Komisionerit Publik në konkluzionet përfundimtare se, për shkak të mosdeklarimit të veprimeve juridike dhe transaksioneve financiare nga subjekti i rivlerësimit/ personi i lidhur në deklaratat periodike dhe në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit gjendet edhe në kushtin e parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vëren se formulimi i ankimit dhe përmbajtja e shkaqeve ankimore të ngritura nga Komisioneri Publik lidhen vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe njëri prej shkaqeve ankimore në kontekstin e të cilit bëhet ky konstatim, është aktiviteti tregtar i shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 2005-2007, me ortak të vetëm dhe administrator bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Sipas arsyetimit të dhënë në paragrafët 23.2.6 – 23.2.8, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i tij nuk kanë pasur detyrimin për deklarimin e veprimeve juridike dhe financiare të kryera nga shoqëria tregtare në administrim të personit të lidhur, subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e funksionit të tij si prokuror,

nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit me z. R. K.³⁵, si dhe nuk ka pasur çështjeve civile të mundshme të inciuara nga z. R. K., në cilësinë e paditësit, kundër z. F. M. si i paditur, në periudhën 2005-2021, sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 15.11.2021.

23.2.10 Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues konkludon se personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit nuk mbarte detyrimin për deklarimin e këtyre veprimeve juridike dhe transaksioneve financiare lidhur me to në deklaratat vjetore të pasurisë, si dhe në deklaratën *vetting*, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, as në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

23.3 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se për aktivitetin tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 2005-2007, nuk janë kryer hetime nga ana e Komisionit për situatën e konfliktit të mundshëm të interesit mes subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror me palët e përfshira në marrëdhënie me këtë shoqëri, të cilat, nga aktet e administruara, rezultojnë se janë shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, si dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre, përkatësisht znj. E. D. dhe z. G. D., si dhe shtetasi R. K., trupi gjykues konstaton:

23.3.1 Në analizë të akteve të administruara nga Komisioni, si dhe të rezultave të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se në dosjen e Komisionit nuk janë administruar akte lidhur me çështjen e konfliktit të interesit të pretenduar nga Komisioneri Publik me palët e sipërcituara pasi, sikurse rezultoi, shkresa e ASHK-së nr. {***} prot., datë 25.11.2021, nuk është administruar nga Komisioni dhe, si rrjedhim, subjekti i rivlerësimit nuk është pyetur dhe as nuk ka dhënë shpjegime, si dhe nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me këtë çështje.

23.3.2 Subjekti rivlerësimit, lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, u shpreh për herë të parë gjatë gjykimit në Kolegj, duke parashtruar se gjatë ushtrimit të funksionit të tij si prokuror, asnjëherë nuk ka pasur çështje në hetim apo në gjykim me subjekt procedural shtetasit R. K., G. D. dhe E. D., qoftë këta persona si viktimë apo të pandehur, fakt që përputhet sipas subjektit dhe me konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së, të datës 01.10.2018, drejtuar Komisionit. Në konkluzionet përfundimtare, subjekti përkundër parashtrimit të Komisionerit se për periudhën janar 2005 – dhjetor 2006, nuk është administruar përgjigje për mungesën e konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit si prokuror dhe shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK dhe përfaqësuesve të tyre, përkatësisht G. D. dhe E. D., saktësoi se gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë pjesë e seksionit “Njësia e përbashkët hetimore” apo seksionit kundër krimit ekonomik dhe financiar, që mbulonin veprat penale të kryera nga shoqëritë tregtare. Për këtë arsye, nuk ka trajtuar kallëzime, si dhe nuk ka ndjekur hetim dhe nuk ka përfaqësuar në gjykim çështje penale me subjekte procedurale këto shoqëri dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre.

23.3.3 Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi të Komisionerit Publik, si pjesë përbërëse e shkaktit ankimor për aktivitetin tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, në periudhën 2005-2007, çeli hetimin gjyqësor në përfundim të të cilit administroi në cilësinë e provës, përgjigjet zyrtare të dërguara në adresë të subjektit të rivlerësimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në përgjigje të dy kërkesave të saj për informacion³⁶ dhe kthim përgjigjen e

³⁵ Trajtohet në paragrafin 23.3 të këtij vendimi.

³⁶ i) Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës së regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me nr. prot. {***}, datë 27.09.2021, ka kërkuar informacion nëse gjatë kohës që ka ushtruar funksionin si prokuror,

Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. {***} prot., ({***}), datë 17.11.2021, drejtuar Kolegjit. Nga analizimi i përmbajtjes së këtyre provave, rezultoi se:

1. subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës kohore 2007-2021, nuk ka ndjekur materiale kallëzuese për shtetasin R. K., sipas shkresës “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 29.09.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar subjektit të rivlerësimit;
2. subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës kohore 2007-2021, nuk ka hetuar shtetasit G. N. D. dhe E. (E.) G. D., sipas shkresës “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 04.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar subjektit të rivlerësimit.
3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 2014-2021, nuk ka shqyrtuar materiale për shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, sipas shkresës “Kthim përgjigje” nr. {***} prot. ({***}), datë 17.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar Kolegjit.

23.3.4 Trupi gjykues, në dritën e provave të analizuara më sipër, të cilat si akte zyrtare kanë fuqi të plotë provuese për përmbajtjen e tyre sipas nenit 253³⁷ të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në vlerësimin e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit të tij si prokuror, nuk është ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit me shoqëritë “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, me përfaqësuesit e këtyre shoqërive, E. D. dhe G. D., si dhe me shtetasin R. K..

24. Në analizë të gjithë sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimor, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe as në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e këtij ligji. Si rrjedhim, Kolegji e gjen të pabazuar këtë shkak ankimor të ngritur nga Komisioneri Publik.
25. *Për shkakun e ankimit që lidhet me burimet e krijimit të pasurisë “Apartament banimi me sipërfaqe 68,8 m² në Tiranë”, trupi gjykues konstaton si më poshtë.*

25.1 Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar: *apartament banimi me sipërfaqe 68,8 m², në qytetin e Tiranës, blerë në vitin 2008, në shumën 38 mijë euro, nga të cilat 30 mijë kredi, 5 mijë hua pa kontratë dhe pa interes nga A. Gj. (daja), si dhe 3 mijë kursime nga të ardhurat nga puna; pronë individuale. Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 4.4.2008, regjistruar në regjistrin hipotekor në ZVRPP Tiranë me nr. {***}, datë 24.4.2008, nr. pasurie {***}. Pjesa takuese: 100%.*

ka trajtuar kallëzime penale, ka hetuar apo ka përfaqësuar në gjykim çështje penale me subjekt procedural (viktimë/autori i veprës penale) shtetasin R. H. K..

(ii) Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, më datë 01.10.2021, ka kërkuar informacion nëse gjatë periudhës korrik 2005 - shkurt 2021, si prokuror, ka trajtuar kallëzime penale, ka hetuar apo përfaqësuar në gjykim çështje penale me subjekt procedural (viktimë/autori i veprës penale) shtetasit G. D. dhe E. D..

³⁷ Neni 253 parashikon: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

25.2 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) *kredi për blerje apartament banimi, rruga “{***}”, në shumën 30.000 euro nga NBG bank; (ii) hua në shumën 5.000 euro për blerjen e apartamentit, dajës tim A. Gj., pa kontratë noteriale, marrë në prill 2008, pa interes.*

25.3 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, rezulton se Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri³⁸ ka konfirmuar se në pronësi të subjekti të rivlerësimit rezulton e regjistruar pasuri e lloji apartament, me sipërfaqe 68,8 m², vol {***}, faqe {***}, {***}. Origjina e kësaj prone është kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.04.2008, e lidhur mes shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, dhe znj. Lindita Male, në cilësinë e blerësit.

25.4 Pagesa e kështit të parë³⁹ për pasurinë “apartament” është kryer nga subjekti i rivlerësimit më datë 15.04.2008, në vlerën 9.000 euro, me mandatin nr. {***}, datë 15.04.2008⁴⁰. Për krijimin e kësaj shume, sipas deklarimeve të subjektit përpara Komisionit, ka shërbyer shuma 312.472 lekë, e cila ka qenë gjendje në llogarinë e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”, në datën 31.12.2006, e tërhequr dhe e mbajtur *cash* në vitin 2007, e përdorur në vitin 2008, por e padeklaruar, e plotësuar dhe me disa kursime të vitit 2008, si dhe huaja e dhënë nga personi tjetër i lidhur, daja i saj, në vlerën 5.000 euro, në prill të vitit 2008. Në datën 19.05.2008, me disbursimin e kredisë, është bërë njëkohësisht dhe likuidimi i plotë i çmimit të shitjes së apartamentit.

25.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni⁴¹, ka deklaruar huan në shumën 5.000 euro, pa interes, që ka marrë në prill të vitit 2008, nga z. A. Gj., daja i saj, dakordësinë me huadhënësin për fillimin e shlyerjes me vonesë dhe me pjesë, si dhe shlyerjen e plotë në korrik të vitit 2015. Bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar dokumentacionin provues lidhur me mundësinë financiare të dajës për krijimin e shumës së huas⁴². Ndërsa në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur se shuma e marrë hua nga daja përfaqëson kursimet e tij familjare ndër vite, si një person që ka qenë në marrëdhënie pune prej 37 vitesh, përfshirë dhe aktivitet privat, si dhe punësimin e bashkëshortes për rreth 33 vite, të ardhurat e së cilës nuk janë përfshirë në bilancin familjar dhe punësimin e fëmijëve të huadhënësit, njëri nga të cilët me banim prej vitesh në ShBA. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka

³⁸ Shkresa e ASHK-së nr. {***} prot., datë 27.7.2020, drejtuar Komisionit.

³⁹ Në datën 19.05.2008, me disbursimin e kredisë sipas dokumentit bankar për ekzekutimin e e transferimit të fondeve të kredisë së marrë nga ish-NBG Bank, në shumën 29.414 euro, është kryer pagesa e plotë e çmimit të blerjes së apartamentit.

⁴⁰ Bashkëlidhur pyetësorit II.

⁴¹ Pyetësori I.

⁴² Certifikatë personale dhe familjare e A. Gj.; licencë në projektim {***} dhe zbatim {***}, lëshuar për A. Gj.; ekstrakt i regjistrimit tregtar për “{***}” ShPK me administrator A. Gj.. Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme të dy fëmijëve të dajës (L. dhe Xh. Gj.) për vitet 2006-2008, për të ardhurat nga paga; librezat e punës të L. dhe Xh. Gj.; librezat e punës për L. Gj., si dhe nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, dega Komuna Parisit (old statement) nga 14.09.2007 - 31.12.2012 për A. Gj..

dorëzuar dokumentacion shtesë⁴³ për të ardhurat familjare të z. A. Gj. dhe bashkëshortes së tij, të pallogaritura më parë në bilancin familjar, si edhe aktekspertimin kontabël, datë 18.12.2020, të kryer nga një kontabilist i miratuar.

25.6 Komisioni, në vijim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe paraqitjes së dokumentacionit, në përgjigje të barrës së provës, u bind për aftësinë paguese nga burime financiare të ligjshme të z. Gj. për dhënien e huas, duke arsyetuar dhe arritur në përfundimin se: [...] *1.10 Lidhur me huan në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, pa kontratë dhe pa interes nga daja i subjektit, z. A. Gj., trupi gjykues, pasi vlerësoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, arrin në konkluzionin se ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për dhënien e kësaj huaje. Po ashtu, rezulton e deklaruar marrja dhe shlyerja e saj edhe në DPV-të e subjektit të rivlerësimit.*

1.11 Lidhur me shumën 3.000 (tre mijë) euro, për plotësimin e shumës totale për blerjen e apartamentit, trupi gjykues vlerëson se shuma prej 312.472 lekësh, gjendje në llogarinë e pagës së subjektit në "Raiffeisen Bank", në datën 31.12.2006, e tërhequr dhe e mbajtur cash në vitin 2007, dhe e përdorur në vitin 2008 dhe e padeklaruar, nuk mund të pranohet nga Komisioni, pasi nuk është deklaruar as si burim në deklarinë vetting dhe as si kursim cash i mbajtur në banesë, në DPV-të përkatëse.

1.12 Nga analiza financiare për vitin 2008, subjekti rezulton me një balancë negative të tillë, e cila nuk mund të vlerësohet se e klasifikon subjektin e rivlerësimit në ndonjë nga kushtet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2018, duke vlerësuar, gjithashtu, me rezervë shpenzimet jetike në raport me jetën modeste të subjektit të rivlerësimit, të rezultuar gjatë hetimit⁴⁴.

25.7 Komisioneri Publik, në konkluzionet përfundimtare për këtë shkak ankimi, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me burime të ligjshme të pagesës të kështit të parë të apartamentit me sipërfaqe 68 m², të kryer në datën 15.04.2008, pasi: (i) në analizë të pretendimeve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, si dhe bazuar në rekomandimin e ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mundësinë e huadhënësit, z. A. Gj., për të mbuluar me burime të ligjshme huan në shumën 5.000 euro, dhënë subjektit të rivlerësimit; (ii) subjekti, sikurse ka parashtruar dhe në ankim, nuk arriti të provojë të kundërtën, për sa ka konstatuar Komisioni lidhur me pamjaftueshmërinë financiare për burimin e deklaruar: *kursime në shumën 3.000 euro*⁴⁵. Ky konstatim, sipas Komisionerit Publik, i vlerësuar në harmoni me gjetjet e pasqyruara më lart, mbetet për t'u konsideruar si element në verifikimin e rastit të parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

25.8 Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, e kundërshtoi këtë shkak ankimor me argumentin se personi tjetër i lidhur, daja i tij, ka pasur të ardhura të ligjshme të

⁴³ Dokumentacioni dërguar subjektit të rivlerësimit nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (Drejtoria Rajonale Tiranë), në përgjigje të kërkesës së tij, protokolluar me nr. {***}, datë 01.12.2020.

⁴⁴ Shih vendimin e Komisionit (faqe 9-10).

⁴⁵ Komisioneri Publik, ashtu si Komisioni, i referohen shumës prej 3.000 (tre mijë) eurosh, si shtesë nga kursimet për të plotësuar vlerën e parapaguar, bazuar në deklarinë e subjektit, por nga mandatpagesa nr. {***}, datë 15.04.2008, rezulton se vlera totale e parapaguar nga subjekti është 9.000 euro, pra shtesa e kryer nga ana e subjektit, rezulton të jetë 4.000 (katër mijë) euro.

mjaftueshme për krijimin e kursimeve dhe përpara vitit 2005⁴⁶ dhe për dhënien e huas në vlerën 5.000 euro, nëse në analizën financiare të familjes Gj.⁴⁷ do të llogariteshin edhe të ardhurat e dajës dhe bashkëshortes së tij, para vitit 2006, si dhe do të zbriteshin shpenzimet për M. Gj. (vajza e dajës), e cila është natyralizuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën 19.08.2008, proces i cili sipas subjektit kërkon paraprakisht një rezidencë të ligjshme së paku 5 vite përpara aplikimit për fitimin e shtetësisë me natyralizëm, edhe pse përbërja familjare e familjes Gj., në periudhën 31.12.2005 - 31.12.2008, rezulton me 6 persona (përfshirë dhe M. Gj.), sipas certifikatës familjare të depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. {***} prot., datë 09.11.2021, në përgjigje të kërkesës për informacion të Kolegjit⁴⁸.

25.9 Trupit gjykues, bazuar në analizën financiare të kryer në Kolegj, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm se personi tjetër i lidhur, z. A. Gj., kishte burime të ligjshme për të krijuar plotësisht pasurinë likuiditet, në shumën 5.000 euro, si dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar kursimet e tij *cash* në shumën 4.000 euro, të përdorura për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

25.10 Kolegji analizoi mundësinë e krijimit të vlerës prej 9.000 eurosh, paguar si kapar për blerjen e pasurisë “apartament” nga subjekti i rivlerësimit, sipas mandatit nr. {***}, datë 15.04.2008, bazuar në dy burimet e krijimit të deklaruar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit: i. huan në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, pa kontratë dhe pa interes nga daja i subjektit, z. A. Gj.; ii. shumën 4.000 (katër mijë) euro⁴⁹, për plotësimin e vlerës totale të parapaguar, krijuar sipas subjektit nga shuma 312.472 lekë, e cila ka qenë gjendje në llogarinë e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”, në datën 31.12.2006, e tërhequr dhe e mbajtur *cash* në vitin 2007, e përdorur në vitin 2008, por e padeklaruar, e plotësuar dhe me disa kursime të vitit 2008.

25.11 Në lidhje me huan në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, pa kontratë dhe pa interes nga daja i subjektit, z. A. Gj., Kolegji ka në konsideratë faktin se analiza financiare e kryer për mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për pagesën e këstit të parë për apartamentin, mbështetet në të dhëna jo të plota për sa i përket mundësisë financiare të familjes së A. Gj. për krijimin e kursimeve në një kohështrirje përpara vitit 2005, si dhe të kontributit të mundshëm të dhënë nga znj. M. Gj. (L.)⁵⁰, e cila, edhe pse e larguar nga familja e origjinës për shkak të natyralizimit në Shtetet e Bashkuar të Amerikës, bazuar në deklarimet e subjektit, ka kontribuar në familjen Gj., duke rritur mundësitë e familjes për krijimin e kursimeve ndër vite.

⁴⁶ Konkluzionet përfundimtare të subjektit, dorëzuar në seancën e datës 02.12.2021 (faqe 13).

⁴⁷ Raporti i ekspertit kontabël për llogaritjen e të ardhurave, dorëzuar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

⁴⁸ Me kërkesën nr. {***} regj., datë 28.10.2021, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme të Gjendjes Civile, Kolegji kërkoi informacion për gjendjen familjare të z. A. Xh. Gj., lindur në Tepelenë, më datë {***}, për vitet 2005-2008.

⁴⁹ Referencë në poshtëshënimin nr. 45.

⁵⁰ Vajza e A. dhe B. Gj..

25.12 Duke pasur në konsideratë këto rrethana, Kolegji kreu analizën financiare duke përfshirë në përlogaritje të ardhurat e A. dhe B. Gj. për periudhën 2005 - mars 2008 dhe të ardhurat e L. dhe Xh. Gj. [dy nga fëmijët e A. Gj.t] për periudhën 2006 -mars 2008⁵¹, si dhe shpenzimet e jetesës për kategorinë “familje me 5 persona +”, sipas standardit të ILDKPKI/INSTAT⁵². Nga kjo analizë, rezulton se familja Gj. gjendet në kushtet e pamundësisë financiare për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit, shumën prej 5.000 euro.

25.13 Në lidhje me shumën 4.000 (katër mijë) euro, për plotësimin e vlerës totale të parapaguar për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit, nga aktet e administruara në dosje, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *vetting* shumën 3.000 euro si kursime nga të ardhurat nga puna që kanë shërbyer së bashku me huan e marrë nga daja i tij, në vlerën 5.000 euro si burim për të plotësuar pagimin e këstit të parë për apartamentin në fjalë.

25.13.1 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar përpara Komisionit se një shumë prej 312.472 lekësh, e cila ka qenë gjendje në llogarinë e tij të pagës në datën 31.12.2006, në “Raiffeisen Bank”, është tërhequr dhe mbajtur *cash* prej tij në vitin 2007, për t'u përdorur si burim për këstin e parë për blerjen e apartamentit në vitin 2008. Duke qenë llogari e pagës, e marrë nga detyra si prokurore dhe hedhur nga institucioni ku punonte, subjekti e ka parë si të panevojshëm deklarin si kursim, pasi e ka konsideruar si vlerë të kontrollueshme, duke qenë se bëhet fjalë për mbetje të pagës. Më pas, si pasojë dhe e udhëzimeve të nxjerra nga ILDKPKI-ja, ka deklaruar gjithçka. Sipas subjektit, fakti që shuma ka ekzistuar, nuk mund të mos llogaritet në analizë, pasi është e ardhur e fituar nga puna dhe mosdeklarimi në deklaratë, nuk e fshin apo shuan atë. Plotësimi i shumës 3.000 (tre mijë) euro për blerjen e apartamentit, është mundësuar edhe nga kursime të tjera deri në prill të vitit 2008.

25.13.2 Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë për vitet 2007 dhe 2008, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, shumën 312.472 lekë gjendje në llogarinë e pagës në datën 31.12.2006, tërhequr dhe e mbajtur *cash* në banesë si vlerë likuiditeti në vitin 2007. Gjithashtu, subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje *cash*, e mbajtur në banesë dhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2008. Ky mosdeklarim i subjektit vjen në kundërshtim me detyrimin e parashikuara në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, neni 4, gema “d”, e cila parashikon detyrimin e subjekteve për të deklaruar vlerën e likuiditeteve në gjendje *cash*, të mbajtur jashtë sistemit bankar.

25.13.3 Referuar jurisprudencës së Kolegjit mbi vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vepruar drejt që nuk ka pranuar shpjegimin e subjektit në lidhje me përdorimin e kësaj shume si burim për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 68,8 m², për sa kohë kjo shumë e konsideruar si e ardhur për subjektin e rivlerësimit në formën e kursimit, nuk është deklaruar prej tij në kohën kur është poseduar dhe më pas përdorur dhe, në këto kushte, shpjegimi i subjektit rezulton se nuk mbështetet në prova dhe mbetet në nivel deklarativ.

25.13.4 Për sa më sipër, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të kryer në Kolegji lidhur me përcaktimin e mundësisë financiare të

⁵¹ Bazuar në të dhënat e dërguara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për këta individë.

⁵² Pra, pa përfshirë në analizë të ardhura apo shpenzime jetese për vajzën M. L..

subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme shumën 9.000 euro, që ka shërbyer për pagesën e kështit të parë të apartamentit me sipërfaqe 68,8 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

26. Bazuar në sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimor, në përfundim Kolegji konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagimin e kështit të parë prej 9.000 eurosh, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 68,8 m², në rrugën “{***}”, Tiranë”, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, por e cila u konkludua nga trupi gjykues se nuk është e mjaftueshme për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

27. Në lidhje me shkakun ankimor mbi huamarrjet në periudhën 1993-1994 të personit të lidhur, z. F. M., trupi gjykues konstaton si më poshtë.

27.1 Në deklaratën *vetting*, në rubrikën përkatëse të detyrimeve, personi i lidhur ka deklaruar: *Akt-detyrimi për kreditimafatgjatë për investime, më datë 12.09.1994, me BKT (sipër emërtimit të asaj kohe), në shumën 2 milionë lekë; me afat 3-vjeçar; me interes 32% me bazë vjetore. Shuma e detyrimit financiar: 1.000.000 lekë. Huamarrje nga të tretë për qëllim të aktivitetit privat, të ushtruar në vitet 1993, 1994. Shuma e detyrimit: 16.100.000 lekë.*

27.2 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2006, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Detyrime të tjera të prapambetura: 16,1 milionë lekë kreditorëve dhe 1 milion lekë B. Kursimeve (viti 1994). Në vlera totale: 17,1 milionë lekë.*

27.3 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2003, për sa u përket detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, personi i lidhur ka deklaruar: *Detyrime të prapambetura të mbyllura në bilancin e vitit 1994, Përmet; vlefte – 17 milionë lekë; vendndodhja e subjektit që i detyrohet – Banka e Kursimit Përmet (klientë); arsyeja e krijimit të detyrimit - nga aktiviteti tregtar i vitit 1993-1994.*

27.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve të dërguara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁵³, si dhe në shpjegimet për rezultatet e hetimit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke u shprehur se fondet e marra hua janë përdorur në funksion të aktivitetit të shoqërisë së bashkëshortit deri në kohën kur është ushtruar aktivitet, në dhjetor të vitit 1994. Subjekti, lidhur me raportet e tij me këtë huadhënës, në vijim ka sqaruar se nuk i njeh ata, nuk ka pasur kontakte dhe asnjë prej tyre nuk i është drejtuar për marrëdhënien e huas që ka pasur me bashkëshortin e tij. Gjithashtu, në dijeninë e tij, nuk ka pasur dhe nuk ka çështje gjyqësore civile të shqyrtuara apo në proces gjykimi kundër tij apo kundër bashkëshortit.

27.5 Komisioni, pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: *marrëdhënia e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me aktivitetin e tij tregtar, nuk është objekt deklarimi, përveç pjesës së të ardhurave dhe detyrimeve personale që i ai mbart, të cilat rezultojnë se janë deklaruar nga subjekti në mënyrë korrekte në deklaratën “vetting”. Po ashtu, nga hetimi, nuk ka rezultuar se këto veprimtari të bashkëshortit në marrëdhënien e tij me shoqërinë tregtare, të jenë ndikuar nga subjekti i rivlerësimit, apo ai dhe familja e tij të kenë përfitime ose lidhje të ndryshme interesi me to. Kjo marrëdhënie rezulton të jetë tërësisht objekt i veprimtarisë së një shoqërie tregtare dhe duhet t’i nënshtrohet legjislacionit*

⁵³ Pyetësori II.

përkatës, por nuk mund të lidhet me subjektin dhe procesin e tij të rivlerësimit dhe as mund të ndikojë në dhënien ndaj tij të ndonjë mase disiplinore. Në kuptim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk plotëson asnjë nga kushtet e parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

27.6 Komisioneri Publik, në ankim dhe gjatë gjykimit në Kolegj, parashtroi se nga shqyrtimi i akteve në dosje, si dhe në zbatim të pikës 4, germa “b” e rekomandimit të ONM-së, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk mbështeten në prova të plota dhe, për rrjedhojë, nuk janë shteruese dhe, për këtë arsye, i kërkoi Kolegjit që të hetonte për ekzistencën e çështjeve gjyqësore mes huadhënësve dhe personit të lidhur, z. M., si dhe të administronte informacionin nga organi i prokurorisë nëse subjekti ka hetuar apo ka kryer veprime procedurale në çështje që lidhen me palët huadhënese për të provuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Male, në ushtrimin e detyrës së saj si prokurore me këta huadhënës.

27.7. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, parashtroi se deklaratimet lidhur me të ardhurat dhe detyrimet e bashkëshortit në veprimtarinë tregare, janë bërë në mënyrë korrekte, të saktë dhe në përputhje me situatën reale, si në deklaratat periodike të dorëzuara në ILDKPKI, duke filluar nga deklarimi i parë në vitin 2003, ashtu dhe në deklaratën *vetting*. Huamarrjet u referohen qëllimeve të veprimtarisë tregtare të bashkëshortit në një periudhë shumë të hershme, paraqiten në bilanc dhe pasqyrat financiare të shoqërisë së bashkëshortit për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në vitin 1994, dorëzuar më 31 mars 1995. Në lidhje me çështjet gjyqësore të huadhënësve dhe personit të lidhur F. M., për huamarrjet në periudhën 1993-1994, rezulton se nga viti 1993 dhe aktualisht, në Gjykatën e Rrethit Përmet ka pasur vetëm 6 (gjashtë) procese gjyqësore, me objekt kthim shume, me të paditur “F. M.” (bashkëshorti). Pavarësisht shumës që i është ngarkuar detyrim bashkëshortit në çështjet me paditës huadhënësit të cilëve u është pranuar padia (A. C., D. R. dhe Ll. Th.), rezulton se për këto vendime gjyqësore, nuk është kërkuar asnjëherë lëshimi i urdhrin të ekzekutimit dhe, për rrjedhojë, nuk janë vënë në ekzekutim, duke mos sjellë pasoja financiare në dëm të interesave të bashkëshortit, si dhe të tij personalisht.

27.8 Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimor, pasi analizoi përmbajtjen e shkresave “kthim përgjigje” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet dhe asaj Tiranë, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të kërkesave të tij për informacion, si dhe shkresës “kthim përgjigje” nr. {***} prot. ({***}), datë 17.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, drejtuar Kolegjit, kontatton sa më poshtë.

1. Asnjë nga huadhënësit e shoqërisë “{***}” ShPK nuk është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Përmet, në cilësinë e të pandehurit ose të personit nën hetim, nga verifikimet e kryera në arkivin e kësaj gjykate, sipas shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet nr. {***} prot. {***}, datë 22.04.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit⁵⁴.
2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, me shkresën nr. {***} prot. ({***}), datë 05.11.2021, e ka informuar subjektin e rivlerësimit, se nga verifikimet në arkivin e Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, nuk rezulton të jenë paraqitur në këtë gjykatë, kërkesa penale si persona të kallëzuar, persona nën hetim ose të pandehur ndaj shtetasve D.R. dhe Ll. Th.

⁵⁴ Sipas kësaj shkrese, verifikimet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet nuk kanë qenë të mundura, pasi arshiva e prokurorisë e viteve përpara vitit 1997, është djegur gjatë trazirave të marsit të këtij viti.

3. Subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 2000-2021, nuk ka ndjekur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, materiale hetimore me subjektet e listës së huadhënësve, sikurse rezulton nga shkresat nr. {***} prot., datë 18.10.2021 dhe nr. {***} prot., datë 19.10.2021, të prokurorisë, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të kërkesës së tij për informacion⁵⁵.
4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 2000-2021, nuk ka ndjekur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, materiale kallëzuese apo procedime penale në lidhje me subjektet D.R. dhe Ll. Th., sipas shkresës nr. {***} prot., datë 29.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të kërkesës së tij për informacion⁵⁶.
5. Me shkresën nr. {***} prot. ({***}), datë 17.11.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka informuar Kolegjin se subjekti i rivlerësimit, në periudhën kohore 2014 - 2021, nuk ka shqyrtuar materiale për shtetasit D. R. dhe Ll. Th..

27.9 Në përfundim të shqyrtimit të provave të sipërcituara, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet dhe asaj Tiranë, nuk ka trajtuar material kallëzues, nuk ka hetuar dhe as nuk ka përfaqësuar në gjykim çështje që të kenë pasur për subjekt procedural (viktimë/autor të veprës penale) huadhënësit e deklaruar nga personi i lidhur, bashkëshorti i saj⁵⁷.

27.10. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të plotë të këtij shkaku ankimor, e shtriu hetimin në lidhje edhe me çështje civile gjyqësore të mundshme, me objekt shume, që mund të jenë iniciuar nga huadhënësit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e paditësve, dhe bashkëshortit të subjektit si të paditur. Për këtë qëllim, u morën në shqyrtim në cilësinë e provës, aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si më poshtë:

1. Gjashtë vendime gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet për çështje civile të regjistruara, me palë ndërgjyqëse huadhënësit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e paditësve dhe bashkëshortin e subjektit, si të paditur dhe objekt “*kthim shume*”, nga të cilat për tri çështje është pranuar padia: (i) vendimi nr. {***}, datë 16.11.2001, me paditës A. C.; (ii) vendimi nr. {***}, datë 13.12.1994, me paditës D. R.; (iii) vendimi nr. {***}, datë 13.04.1995, me paditës Ll. Th., ndërsa për tri çështje të tjera është vendosur pushimi i gjyimit⁵⁸.

⁵⁵ Kërkesa e subjektit drejtuar organit të prokurorisë më datë 27.09.2021, ka për objekt dhënie informacioni nëse gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë këtij institucioni, ka trajtuar kallëzime penale, ka hetuar ose ka përfaqësuar në gjykim çështje me subjekt procedural (viktima/autorë të veprës penale) personat që rezultojnë si huadhënës të bashkëshortit të saj.

⁵⁶ Kërkesa e subjektit drejtuar organit të prokurorisë më datë 26.10.2021, ka për objekt dhënie informacioni nëse gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e prokurorit pranë këtij institucioni, ka trajtuar kallëzime penale, ka hetuar ose ka përfaqësuar në gjykim çështje me subjekt procedural (viktima/autorë të veprës penale) personat D. R. dhe Ll. Th. që rezultojnë si kreditorë të bashkëshortit të saj.

⁵⁷ Në dosje rezultojnë të administruara 15 kontrata huamarrjeje dhe 7 aktmarrëveshjeje me shkrim dore, të nënshkruara në periudhën 1993-1994 nga 23 huadhënës të ndryshëm [fotokopje]. Të gjitha kontratat e huamarrjes (15 kontrata) janë hartuar me palë z. F. M., në cilësinë e huamarrësit, por vihet re se në 7 prej tyre, te pjesa e nënshkrimit, është vendosur edhe vula: “Firmë Private {***} Përmet”, dhe në 1 prej tyre është vendosur vula: “{***}, Tiranë”. Të gjitha aktmarrëveshjet me shkrim dore (7 aktmarrëveshjeje), janë hartuar midis huadhënësve dhe “privatit” F. M., në cilësinë e huamarrësit, por vihet re se në 1 prej tyre, te pjesa e nënshkrimit, është vendosur edhe vula “Firmë Private {***} Përmet”, dhe në 3 prej tyre është vendosur vula “{***}, Tiranë”.

⁵⁸ Vendimi nr. {***}, datë 5.6.1995, me paditës Th. J.; vendimi nr. {***}, datë 4.08.1995, me paditës J. Z. dhe L. N.; vendimi nr. {***}, datë 5.12.1995, me paditës të kundërpaditur F. L. dhe Q. Q.

2. Tri vërtetime të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet me nr. {***} prot., nr. {***}, datë 22.04.2021, nr. {***} prot., sipas të cilave rezulton se përkatësisht shtetasit A. C., Ll. Th. dhe D. R. nuk kanë paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimet gjyqësore të sipërcituara për pranimin e padisë.
3. Tri vërtetime të lëshuara nga Zyra Përmbarimore Përmet me nr. {***} prot., datë 22.04.2021, nr. {***} prot., datë 22.04.2021, nr. {***} prot., datë 20.04.2021, sipas të cilave rezulton se pranë kësaj zyre nuk janë depozituar urdhra ekzekutimi apo nuk ndodhen dosje përmbarimore për sa u përket tri vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, të cituara në pikën 3, përkatësisht nga paditësit D. R., Ll. Th. dhe A. C..

27.11 Në analizë të përmbajtjes së provave të sipërcituara, trupi gjykues konstaton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet janë regjistruar vetëm gjashtë çështje civile, me objekt kthim shume nga huadhënësit e bashkëshortit kundër këtij të fundit. Nga këto gjashtë çështje gjyqësore, vetëm për tri prej tyre është marrë vendim nga gjykata për pranimin e padisë, konkretisht për paditësit A. C., Ll. Th. dhe D. R.. Asnjë prej këtyre vendimeve nuk është vënë në ekzekutim të detyrueshëm kundër debitorit, z. F. M., sipas vërtetimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, të cituara në paragrafin 27.10, pika 2 dhe vërtetimeve të Zyrës Përmbarimore Përmet, të cituara në paragrafin 10.3.

28. Trupi gjykues, në përfundim të sa më sipër, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror, nuk u provua që të jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit me huadhënësit e deklaruar nga personi i lidhur dhe, si rrjedhojë, nuk ndodhet në rastin e përcaktuar në nenin 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016. Mungesa e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me huadhënësit e deklaruar nga personi i lidhur, është konstatuar dhe nga Komisioneri Publik në konkluzionet e tij përfundimtare⁵⁹. Si rrjedhojë, Kolegji e gjen të pabazuar këtë shkak ankimor të ngritur nga Komisioneri Publik.
29. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për mungesën e një arsytimi të plotë nga ana e Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterëve të vlerësimit, përfshirë mosdeklarimin nga personi i lidhur të detyrimeve të tij që rrjedhin nga zëvendësimi i debitorit, trupi gjykues vëren se:*

29.1 Komisioneri Publik, duke marrë në konsideratë rekomandimin e ONM-së, të pasqyruar në aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi”, paragrafi “d” e ka përthithur atë në formulimin e këtij shkak ankimor, i cili ka të njëjtën përmbajtje si në ankim, ashtu dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegj⁶⁰.

29.2 Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, ka administruar shkresën nr. {***} prot., datë 18.05.2020, të Agjencisë së Trajtimit të Kredive (në vijim “ATK”)⁶¹, e cila ka konfirmuar se në emër të F. Sk. M., rezultojnë tri kredi të transferuara nga ish-Banka e Kursimeve Përmet, nga të cilat njëra i është akorduar shoqërisë “{***}” ShPK, dhe dy të tjerat i janë akorduar z. G. I., për të cilat me vendimin nr. {***}, datë 29.3.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet është bërë zëvendësimi i debitorit G. I. me debitorin e ri “{***}”.

⁵⁹ Pika 5 e konkluzioneve përfundimtare të parashtruara në seancën gjyqësore të datës 02.12.2021.

⁶⁰ Pika 4 e parashtrimeve të Komisionerit Publik, të depozituara në seancën gjyqësore të datës 20.10.2021.

⁶¹ Sipas ligjit nr. 8894, datë 14.05.2002, “Për Agjencinë e trajtimit të kredive”, i ndryshuar, objekti i veprimtarisë së ATK-së është trajtimi i kredive dhe i asetëve të tjera, të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë, me kapital tërësisht shtetëror të kjo agjenci.

29.3 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për sa i përket mungesës së deklarimit si në deklaratën *vetting*, ashtu dhe në deklaratat e interesave periodikë nga ana e personit të lidhur të detyrimeve të marra përsipër nëpërmjet zëvendësimit të debitorit sipas vendimit nr. {***}, datë 29.03.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, në shumën totale prej 3.917.800 lekësh.

29.4 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet rreth rezultateve të hetimit, është shprehur se ky detyrim nuk është deklaruar për shkak të padijenisë së tij dhe të bashkëshortit për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet të datës 23.02.2002, për të cilin ka marrë djeni gjatë procesit të rivlerësimit. Urdhri i ekzekutimit i datës 19.03.2003, i nxjerrë një vit pas dhënies së vendimit, përmban vetëm akt-detyrimin e huas së datës 12.09.1994. Subjekti është shprehur se do të ndjekë rrugën ligjore lidhur me këtë vendim, pasi ka marrë kopje të dosjes gjyqësore në gjykatë.

29.5 Komisioneri Publik, në konkluzionet përfundimtare⁶², në lidhje me këtë shkak ankimor u shpreh se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mungesën e deklarimit nga personi i lidhur të detyrimeve që rrjedhin nga zëvendësimi i debitorit G. I. me debitorin e ri F. M.. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë në funksion të goditjes gjyqësore, në lidhje me pavlefshmërinë e akteve të përdorura gjatë kryerjes së procedurave gjyqësore, për zëvendësim debitorit ose dhe të vetë vendimit gjyqësor që ka disponuar përfundimisht, duke njohur personin e lidhur në cilësinë e debitorit. Mungesa e dijenisë së personit të lidhur për ekzistencën e këtij detyrimi, duket kontradiktore dhe me përmbajtjen e shkresës nr. {***} prot., datë 05.06.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku konfirmohet se personi i lidhur, z. F. M., figuron i regjistruar si anëtar i bordit të menaxhimit në subjektin “{***}” ShA me aksionar dhe administrator shtetasin G. I..

29.6 Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, u qëndroi deklarimeve dhe shpjegimeve para Komisionit për mungesën e dijenisë së tij dhe të bashkëshortit për këtë detyrim dhe marrjen djeni për të vetëm gjatë procesit të rivlerësimit, duke shtuar se prezenca e bashkëshortit në këtë gjykim, në cilësinë e të paditurit është një fakt i rremë, gjë e cila provohet me mospasjen e asnjë kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm të shumave të marra kredi nga G. I. në Bankën Kombëtare Tregtare. Ky shpjegim vërtetohet dhe me faktin se urdhri i ekzekutimit të vendimit nr. {***}, datë 19.03.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet është nxjerrë një vit pas marrjes së vendimit gjyqësor për zëvendësimin e debitorit dhe ky urdhër për debitorin “{***}” përmban vetëm akt-detyrimin e huas së marrë prej tij në datën 12.09.1994. Sipas subjektit, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.07.2002, të ministrit të Financave të kohës ngarkohen me përgjegjësi drejtuesit e ATK-së për të shlyer gjithë detyrimin e z. F. M., si dhe analizohen parregullsitë e vërtetuara në këtë rast. Sipas subjektit, nëse ATK-ja do të kishte njohur bashkëshortin si debitor apo do të kishte dhënë pëlqimin për zëvendësimin që pretendohet se është kryer, do të kishte nisur një proces civil dhe penal ndaj tij.

29.7. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj aktet e poshtëshënuara.

1. Vendimi nr. {***}, datë 29.03.2002, i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.

⁶² Në ankim, si dhe në parashtrimet e depozituara gjatë seancave gjyqësore, Komisioneri Publik nuk kishte formuluar një qëndrim me shkrim lidhur me këtë shkak ankimor.

2. Urdhër-ekzekutimin e vendimit nr. {***}, datë 19.03.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.
3. Shkresa nr. {***} prot., datë 27.09.2021, e ATK-së, drejtuar subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të kërkesës së saj për informacion, lidhur me fazën e trajtimit të ankesës së bërë nga F. M. lidhur me pretendimin e tij për zëvendësimin e debitorit në dy kreditë e marra nga G. I..
4. Shkresa nr. {***} prot., datë 04.10.2021, e ATK-së, drejtuar subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur saj dhe shkresa nr. {***} prot., datë 25.07.2002, me lëndë “Zëvendësim debitorit” e ministrit të Financave, K. I., drejtuar ATK-së.

29.8 Trupi gjykues, në analizë të përmbajtjes së shkresës nr. {***} prot., datë 18.05.2020, të ATK-së, të administruar gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, shkresave të ATK-së nr. {***} prot., datë 29.09.2021 dhe nr. {***} prot., datë 04.10.2021, drejtuar subjektit të rivlerësimit, konstaton se për vendimin nr. {***}, datë 29.03.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, i cili përbën titull ekzekutiv në kuptim të nenit 510, germa “a”⁶³ e Kodit të Procedurës Civile nuk është lëshuar një urdhër ekzekutimi.

29.9 Trupi gjykues, pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosdijeninë e tij dhe të bashkëshortit lidhur me detyrimin e tij për shkak të zëvendësimit të debitorit, sipas vendimit nr. {***}, datë 29.03.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, e vlerësoi bazuar edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, pjesa e katërt, neni 510 e vijues, lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Këto dispozita kërkojnë si kusht të domosdoshëm lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, me qëllim fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli ekzekutiv (neni 511). Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbartimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbartuesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit, sipas nenit 515 të këtij Kodi. Përmbartuesi gjyqësor, me fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh (kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim) dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera (neni 517). Në mungesë të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, nuk mund të kryhet procedura për ekzekutimin e detyrueshëm të një titulli ekzekutiv. Kjo procedurë kërkon domosdoshmërisht lajmërimin e debitorit si kusht për vijimin e dhe kalimin në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, gjatë së cilës vendoset sekuestro mbi llogaritë e debitorit ose pasurive të tij, sipas nenit 519, në varësi të llojit dhe vlerës së detyrimit, sikurse ka ndodhur me procedurën e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit, vendimi nr. {***}, datë 19.03.2003, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet në favor të kreditorit, ATK-së, kundër debitorit “{***}”, për detyrimin e tij ndaj ish-Bankës Kombëtare Tregtare, të marrë në vitin 1994.

⁶³ Neni 510, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile (përpara ndryshimeve të kodit të miratuara me ligjin nr. 10052, datë 29.12.2008), parashikonte: “Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë, vendimet e dhëna prej tyre për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm”.

ATK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.11.2021, informoi Kolegjin se kjo procedurë ekzekutimi ka filluar në vitin 2008 dhe aktualisht është në fazën e sekuestros mbi llogaritë e debitorit.

29.10 Kolegji çmoi se mosdijenia e subjektit të rivlerësimit për detyrimin e bashkëshortit të saj, që rrjedh nga vendimi nr. {***}, datë 29.03.2002, i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, e justifikuar nga subjekti dhe për shkak se për këtë vendim gjyqësor, ATK-ja, në cilësinë e kreditorit, nuk ka kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, nuk e shmang atë nga detyrimi ligjor për të deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë, përfshirë dhe detyrimet e personit të lidhur sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

29.11 Kolegji, bazuar në aktet e administruara në fashikullin e çështjes dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, të marra në cilësinë e provës, gjatë gjykimit të çështjes, si dhe në shpjegimet e dhëna prej tij në kuadër të këtij gjykimi, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni, në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, për ekzistencën e detyrimit që bashkëshorti i tij, z. F. M., ka pasur sipas vendimit nr. {***}, datë 29.03.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, nëpërmjet të cilit ai ka zëvendësuar debitorin G. I., në marrëdhënien e detyrimit me ATK-në.

29.12 Trupi gjykues, në vlerësimin e pretendimit të Komisionerit Publik, mbajti në konsideratë dhe veprimet e subjektit të rivlerësimit për deklarimin e detyrimeve të personit juridik privat, F. M., në vitet 1993-1994, në deklaratat vjetore të pasurisë dhe në deklaratën *vetting* dhe, bazuar edhe në këtë qasje të subjektit të rivlerësimit në vite, nuk gjeti motiv/arsye për veprime të qëllimshme të tij për mosdeklarimin e këtij detyrimi në deklaratën *vetting*.

- 30.** Bazuar në gjithë sa u arsyetua më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni për këtë detyrim të personit të lidhur, bashkëshortit të saj, ndërkohë që edhe pse ky mosdeklarim është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk e konsideron atë të mjaftueshëm për t’u kualifikuar sipas nenit 61, pika 3 e këtij ligji. Si rrjedhojë, Kolegji e gjen të pabazuar këtë shkak ankimor të ngritur nga Komisioneri Publik.

Trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve ankimore të Komisionerit Publik lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, bazuar në analizën e fakteve, si dhe në provat e administruara gjatë gjykimit për secilin shkak ankimor, arriti në konkluzionet e pasqyruara në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.

1. Për aktivitetin tregtar të personit të lidhur, z. F. M., në periudhën 2005-2007 dhe çështje të lidhura me të, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe as në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

2. Për burimet e krijimit të pasurisë “Apartament banimi me sipërfaqe 68,8 m² në Tiranë”, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për pagimin e këstit të parë të apartamentit me

sipërfaqe 68,8 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, por e cila u konkludua nga trupi gjykues se nuk është e mjaftueshme për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3. Për huamarrjet në periudhën 1993-1994 të personit të lidhur, z. F. M., subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës si prokuror, nuk u provua që të jetë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit me huadhënësit e personit të lidhur dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në rastin e përcaktuar në nenin 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

4. Lidhur me mungesën e një arsytimi të plotë nga ana e Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterëve të vlerësimit, përfshirë mosdeklarimin nga personi i lidhur të detyrimeve të tij që rrjedhin nga zëvendësimi i debitorit, u krijua bindja se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni për këtë detyrim të personit të lidhur, bashkëshortit të saj, ndërkohë që edhe pse ky mosdeklarim është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk e konsideron atë të mjaftueshëm për t’u kualifikuar sipas nenit 61, pika 3 e këtij ligji.

31. Për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm për këtë kriter vlerësimi. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm dhe kualifikues edhe për sa u përket dhe dy kriterëve të tjera, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, pasi është vlerësuar “i përshtatshëm” për vazhdimin e detyrës dhe “i aftë” profesionalisht.
32. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e figurës, si dhe nivel kualifikues për aftësinë profesionale, vlerëson se subjekti nuk ka cenuar besimin e publikut dhe, në këto kushte, nuk mund të aplikohet masa e shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të sa më sipër, Kolegji arriti në përfundimin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, si dhe në vlerësimin tërësor nuk ka cenuar besimin e publikut, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi dhe në legjislacionin e zbatueshëm.

Në këto kushte, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 332, datë 12.01.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri), është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për pasojë duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 332, datë 12.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male (Ziguri).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.12.2021.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, përkatësisht me cilësinë e relatores dhe anëtares së trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik, kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me numër 332/2021, me subjekt rivlerësimi, znj. Lindita Male (Ziguri), votuam për ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për shkaqe të cilat, ndonëse të lidhura me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vlerësimin tonë përbëjnë cenim të besimit të publikut te drejtësia, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Në vijim të rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit⁶⁴ (ONM), Komisioneri Publik, në ankim, argumentoi: (i) nevojën për hetim të plotë të personit juridik, të themeluar dhe administruar nga personi i lidhur, z. F. M., për periudhën 2005-2007, si dhe hetimin për konflikte interesi të mundshme të subjektit të rivlerësimit, në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror me palët e përfshira në transaksione; (ii) nevojën për hetim të huamarrjeve të personit të lidhur në vitet 1993-1994, parë në funksion të çështjeve gjyqësore mes huadhënësve dhe personit të lidhur, si dhe konfliktet e mundshme të interesit me subjektin e rivlerësimit, në ushtrimin e detyrës si prokuror me këta huadhënës⁶⁵; (iii) nuk u provua mundësia financiare e huadhënësit për t’i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 5.000 euro, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit [me sip. 68,8 m²] nga subjekti i rivlerësimit. Ky aspekt i vlerësimit pasuror për subjektin, u kërkua të hetohej përpos “sa konstatuar nga Komisioni, lidhur me burimin e deklaruar nga subjekti – kursime në shumën 3.000 euro⁶⁶” kundrejt mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit; dhe (iv) arsyetim për vlerësimin tërësor të kriterëve, meqenëse arsyetimi i Komisionit, ndër të tjera, edhe për mungesën e deklarimit të detyrimeve që rrjedhin si rezultat i zëvendësimit të debitorit nga personi i lidhur, ka mangësi në kontekstin e detyrimit për një vlerësim tërësor të kriterëve të rivlerësimit.
3. Votuam kundër vendimit të shumicës për shkaqet e ankimit të cilave Komisioneri u qëndroi në përfundim të procesit, pasi, në vlerësimin tonë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit pasuror dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhej të ishte ndryshuar, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Në vlerësimin tonë të fakteve dhe provave, për subjektin e rivlerësimit duhej të ishte prezumuar në favor të masës së shkarkimit nga detyra, për shkak të deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë në funksion të cenimit të besimit

⁶⁴ <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/03/15.Rekomandim-p%C3%ABr-vendimin-e-KPK-s%C3%ABnr-332dat%C3%AB-12.1.2021.pdf>. Rekomandimi i ONM-së kërkon që nëpërmjet shqyrtimit të ankimit, Kolegji: (i) të vlerësojë çështjet që lidhen me pasurinë dhendikimin e tyre në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit; (ii) të kryejë një analizë të saktë financiare; dhe (iii) të sigurojë një arsyetim të plotë për çështjet në diskutim.

⁶⁵ Ky shkak ankimi u konsiderua i shteruar në procesin publik në Kolegj nga Komisioneri, pasi nuk u konstatuan problemet e konfliktit të mundshëm të interesit të subjektit, në detyrën e tij si prokuror.

⁶⁶ Faqe 13 e ankimit të Komisionerit Publik, paragrafi 23.11.

të publikut në sistemin e drejtësisë, parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për lehtësi referimi, vlerësimi ynë në vijim është shtjelluar duke ndjekur shkaqet e ankimit, përmbledhur më sipër.

I. Mungesa e deklaramit të veprimeve tregtare të kryera nga personi i lidhur

4. Është fakt i pakontestueshëm që, më datë 7 korrik 2005, personi i lidhur/bashkëshorti (në vijim “personi i lidhur”) i subjektit të rivlerësimit, në emër të personit juridik të krijuar, administruar dhe pronë e atij vetë, ka lidhur kontratë bashkëpunimi me një person tjetër juridik⁶⁷. Sipas kësaj kontrate, personi i lidhur, në cilësinë e administratorit të shoqërisë {***} ShPK, merr cilësinë e investitorit në një objekt për të cilin është lëshuar një leje ndërtimi⁶⁸. Është po ashtu fakt i pakontestueshëm që, më 1 nëntor 2006, personi i lidhur ka nënshkruar një kontratë porosie me një individ [z. R. K.], për shitjen e dy apartamenteve prej 125 m² secili, në shumën 225.000 euro, të ndarë në dy këste: i pari do të paguhej nga porositësi ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa i dyti në momentin e lëvrimit të kredisë nga porositësi. Në zbatim të sa më sipër, nga aktet në fashikull, rezulton që porositësi ka transferuar në llogarinë personale të personit të lidhur, z. F. M., 99.000 euro më datë 12 janar 2007. Nga aktet, rezulton gjithashtu që personi i lidhur e ka tërhequr të gjithë shumën prej 99.000 eurosh nga NBG-ja. Së fundmi, është fakt i pakontestueshëm që, në vijim të kontrollit të ushtruar nga organet tatimore më datë 11 maj 2007, është hartuar një *raport kontrolli* më datë 16 maj 2007, në të cilin janë konstatuar një sërë parregullish, përfshirë mungesë pasqyrimi e veprimeve ekonomike në ndërtim, mosdeklarim dhe mosderdhje e detyrimeve financiare, si dhe ndërtim në shkelje të lejes së ndërtimit – gjashtë (6) kate përtej lejes së ndërtimit – në lidhje me objektin e ndërtuar në rrugën “{***}”. Ky raport kontrolli është nënshkruar edhe nga personi i lidhur, në cilësinë e investitorit. Është fakt i pakontestueshëm që në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën e pasurisë [vetting], subjekti apo personi i lidhur nuk ka deklaruar asnjë nga këto veprime, parë si në këndvështrim të natyrës së detyrimeve financiare, ashtu edhe të veprimeve juridike të kryera.
5. Shumica vlerësoi se, meqenëse personi i lidhur nuk rezulton të ketë përfituar kredinë e cituar në kontratën e bashkëpunimit me “{***}” ShPK, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur detyrime, pasi nuk ka pasur përfitime financiare nga transaksionet, ishte i besueshëm. Nuk ishim dakord me shumicën në këtë konstatim për disa arsye.
6. Së pari, sepse pavarësisht nga pretendimi i subjektit që kushtëzon pasojat ligjore dhe përfitimet financiare të pritshme nga personi juridik, pronë e bashkëshortit të saj, me lëvrimin e kredisë,

⁶⁷ Kontratë bashkëpunimi për sipërfaqe ndërtimi, me nr. {***}, mes F. M., administratori shoqërisë {***} Shpk, në cilësinë e investitorit dhe G. D, administratori shoqërisë “{***}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, me objekt ndërtimin e ndërtesës së referuar në vendimin e KRRT-së me nr. {***}. Financimi do të sigurohej nga {***} ShPK, nëpërmjet kreditimit nga Banka Popullore, me normë fitimi 50%.

⁶⁸ Me vendim të KRRT-së nr. {***}, datë 28.04.2004, lidhur me një godinë banimi dhe shërbimi 5-katëshe, në rrugën “{***}” [Tiranë], në favor të personit juridik {***} ShPK. Ky dokument është përcjellë nga vetë subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, më 21.03.2016.

rezulton që të paktën deri në maj 2007, thujse dy vjet pas kontratës së bashkëpunimit të sipërcituar, personit të lidhur si investitor dhe “{***}” ShPK, në cilësinë e bashkinvestitorit sipërmarrës, rezultojnë të jenë ende të përfshirë në biznes bashkërisht, siç dëshmohet qartë nga raport-kontrolli i hartuar nga organet tatimore dhe nënshkruar edhe nga personi i lidhur në maj 2007. Qartazi, kredia e referuar, e pritur nga Banka Popullore, nuk mund të ketë përbërë kusht themelor *sine qua non* për vijimin e cilësisë si bashkinvestitor nga ana e personit të lidhur. Me fjalë të tjera, pavarësisht nëse kredia është lëvruar apo jo, “{***}” ShPK ka vijuar marrëdhënien e bashkëpunimit me personin e lidhur dhe ky i fundit figuron me cilësinë e investitorit.

7. Së dyti, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kontrata noteriale e porosisë e datës 1 nëntor 2006, ishte pjesërisht fiktive dhe në fakt nuk prodhoi pasoja, mbeti deklarativ, parë të paktën në drejtim të pasojave. Nga aktet, rezulton që z. K. respektoi kushtet e kontratës së porosisë – të paktën në kushtet kur kredia prej 99.000 eurosh, e përfituar prej tij në janar 2007, i kaloi personit të lidhur sipas kushteve të kontratës. Sa i përket pagesës që palët ranë dakord të kryhej në ditën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, në shumën prej 40.000 eurosh, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo pjesë e detyrimeve nuk u respektua nga palët, është krejtësisht deklarativ dhe aspak bindës, në kushtet kur z. K. rezulton të ketë respektuar kushtet për detyrimet e tij dhe kërkimin e kredisë e plotësimin e akteve shkresore që shërbejnë për miratimin e saj nga banka përkatëse⁶⁹. Kolegji ka jurisprudencë të konsoliduar tashmë, e cila ka theksuar vlerën provuese të kontratave të lidhura rregullisht nga palët⁷⁰. Për këto arsye, mandatpagesa e lëshuar nga {***} ShPK, që pretendon t’i jetë kthyer shuma porositësit, z. K., në të njëjtën ditë që ky i fundit përfitoi kredinë për të realizuar “anulim kontrate”, duhet të kishte pasur peshë të papërfillshme në analizë të akteve dhe të logjikës së thjeshtë të motiveve për kërkim e përfitim të kredisë nga z. K..
8. Është pa vlerë provuese edhe deklarata noteriale e kryer prej z. K. gjatë kohës kur subjekti i rivlerësimit i ishte nënshtruar kontrollit periodik nga ILDKPKI-ja, më 21.03.2016, ndërkohë që procesi legjislativ që do të krijonte kushtet për rivlerësimin kalimtar të magjistratëve ishte drejt përfundimit. Ndryshe nga shumica, i vlerësuam këto pretendime të përcjella nga subjekti jo vetëm të kryera në funksion të përmirësimit të situatës së saj gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI-ja, por edhe në kontekstin e ndryshimeve që pritej të ndodhnin në procesin e rivlerësimit.
9. Deklarata noteriale [datë 15.03.2016] nga z. K. paraqet probleme kredibiliteti edhe për shkak të mospërputhjeve në themel me kontratën e porosisë. Konkretisht, ndryshe nga kontrata e porosisë

⁶⁹ Shkresa nga ABI Bank [ish-NBG], sipas së cilës, nga kredia e disbursuar në emër të R. dhe B. K., është disbursuar kredia prej 100.000 eurosh në datën 11.01.2006.

⁷⁰ Për vlerën provuese parësore, atribuuar nga jurisprudenca e Kolegjit kontratave të lidhura rregullisht, parë nën dritën e dispozitave të Kodit Civil (neni 690), për referencë ndër të tjera: vendimi i Kolegjit që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Xhoxhaj [JR 09/2018], paragrafi 70-72 dhe 85, vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Camaj [JR 15/2019], paragrafi nr. 35, vendimi që lidhet me subjektin B. Dedja [JR 02/2019], paragrafi 24.8, vendimi që lidhet me subjektin B. Abdullahi [JR 13/2019], paragrafi 74 dhe 75, vendimi që lidhet me subjektin Xh. Zaganjori [JR 19/2019], ndër të tjera paragrafi 29 dhe më tej, vendimi që lidhet me subjektin A. Malaj [JR 27/2019], paragrafi 50, vendimi që lidhet me subjektin A. Zefi [JR 10/2020], vendimi që lidhet me subjektin A. Martini [JR 13/2021], paragrafi 47, vendimi që lidhet me subjektin I. Mustafaj [JR 22/2021], paragrafi 26 me nënpjesët e tij.

që ka për objekt dy apartamente, në deklaratën noteriale z. K. referon një objekt të ndryshëm të rënë dakord – një *njësi shërbimi* dhe një *apartament*. Kjo deklaratë, e kryer thujse 10 vjet pas kontratës dhe kontradiktore me të, paraqet probleme motivimi, parë në analizë të kohës së gjatë që ka kaluar nga momenti kur palët kanë kryer veprimet përkatëse. E vetmja arsye e pranueshme e hartimit mbetet kryerja për shkak të kontrollit nga ILDKPKI-ja, të cilit subjekti i ishte nënshtruar, dhe si zgjatim i pretendimeve të tij se nuk kishte vjelë përfitime financiare.

10. Së fundmi, kjo deklaratë bie haptazi ndesh me aktet e përcjella nga vetë subjekti i rivlerësimit ILDKPKI-së në mars 2016. Ndër aktet në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka përcjellë një letër në të cilën personi i lidhur, në vitin 2008, u drejtohej banorëve të ndërtesës ku ishte bashkinvestitor, duke pretenduar pagesa të munguara prej tyre në favor të tij. Me fjalë të tjera, ndërsa në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit, nën përgjegjësi, sillte prova shkresore për të provuar që personi i lidhur *ishte investitor* në ndërtesën në rrugën “{***}” – siç provohet edhe nga aktet e tjera shkresore të cituara më sipër – haptazi në kontradiktë me shpjegimet e tij përpara ILDKPKI-së, në procesin gjyqësor pretendoi që ajo shkresë e sjellë prej tij, nuk kishte vlerë provuese që personi i lidhur nuk ishte investitor dhe që detyrimet e pashlyera e të pretenduara prej personit të lidhur, nuk pasqyrojnë të vërtetën, siç pasqyrohej në atë shkresë dhe ishte pretenduar prej saj në vitin 2016. Sjellim në vëmendje që letra e sjellë në mbështetje të shpjegimeve nga subjekti në vitin 2016, pretendon edhe detyrime të prapambetura në ngarkim të personit të lidhur ndaj administratës tatimore në vlera të konsiderueshme në vijim të aktivitetit të tij si bashkinvestitor⁷¹. Nga përmbajtja e letrës, deduktohet që personi i lidhur argumenton të ishte investitor, të kishte kontribuar në ndërtimin e objektit nga kati II deri në katin VI dhe të gëzonte të drejta pasurore si rrjedhojë e shitjes së apartamenteve, të drejta të cilat i ishin cenuar për shkak të veprimeve të përfaqësuesit të shoqërisë “{***}” ShPK, bashkinvestitor.
11. Për sa më sipër, e gjejmë qëndrimin e shumicës të pabazuar në fakte, në kushtet kur bie ndesh me gjithë aktet në fashikull, dhe të pabazuar në ligj⁷² dhe në jurisprudencën e Kolegjit mbi vlerën provuese të akteve. Shumica pranon pretendimet e subjektit në Kolegj, të cilat, duke rënë ndesh

⁷¹ Në letrën që mban datën 08.02.2008, me rekuizitë nënshkrimi nga F. M. dhe F. M., shkruhet argumentojnë, ndër të tjera, që ndërtuesi G. D., i cili ka shitur apartamentet (i) nuk është i pajisur me licencë tatimore dhe autorizim nga “ortakët e tjerë”; (ii) z. F. M. ka cilësinë e investitorit dhe është pajisur me licencë nga Tatimet Përmet për ndërtim objekti 5+1 kate; (iii) shkruasi [e paqartë, në kushtet kur janë dy të tillë, por referuar përmbajtjes, prezumohet të jetë z. F. M.] e ka marrë ndërtesën në dorëzim në katin II dhe e ka “çuar deri në katin e gjashtë”; (iii) ndërtimi është pjesërisht pa leje; (iv) z. M. ka paguar tatimet për objektin në Përmet dhe për vitin 2007 mbeten “3 milionë lekë të reja” detyrime të papaguara; (v) ftohen marrësit të gjejnë një zgjidhje bashkërisht me letërshkruerit për të paguar tatimet e prapambetura dhe që të lidhin “kontratat noteriale për shitjet që do të bëhen sipas ligjit në fuqi”; (vi) ftohen marrësit e letrës të raportojnë shumat që kanë paguar për llogari të z. G. D. [pronar dhe administrator i “{***}” ShPK], veprime të cilat janë kryer në mashtrim, sipas letërshkruesve; (vii) jepet afat deri në datën 25 shkurt 2008, pas të cilit kontratat do të quhen të pavlefshme nga dy ortakët e tjerë dhe do të ftohen organet shtetërore, pasi blerësit janë në kushtet e “pushtimit të pallatit”, ndërsa investitorët nuk kanë kryer asnjë shitje; dhe (viii) z. G. D. apo blerësit nuk kanë investuar fondet e tyre në ndërtimin e pallatit i cili “nuk plotëson kushtet teknike”.

⁷² Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton që vendimi duhet të bazohet, ndër të tjera, “[...] në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera [...]”.

me sa ka pretenduar ai vetë në vitin 2016, kryhen në funksion të përmirësimit të pozitës së tij. Këto pretendime të subjektit, të pranuar nga shumica, bien ndesh me logjikën e thjeshtë të bashkëpunimit mbi bazën e përfitimit të dyanshëm mes personit të lidhur dhe bashkinvestitorit. Për këto arsye, e gjejmë të pabazuar analizën e shumicës në pranimin e një deklarate noteriale të hartuar nga porositësi, z. R. K., thujse 10 vjet pasi është zgjidhur marrëdhënia mes tij dhe personit të lidhur, në pritje dhe në funksion të favorizimit të subjektit të rivlerësimit në procesin e rivlerësimit [në mars 2016], me probleme të formës dhe të përmbajtjes, e që bie ndesh me aktet e tjera shkresore, të cilat provojnë përfitimin e shumës 99.000 euro dhe 40.000 euro në periudhën mes nëntorit 2006 dhe janarit 2007.

12. Në arsyetim të sa më sipër, sjellim në vëmendje që, në ndryshim të sa ka konstatuar shumica, në procesin e rivlerësimit, ashtu si edhe në procesin e kontrollit periodik të pasurive, ligjvënësi ka përcaktuar që objekt shqyrtimi përbëjnë edhe detyrimet financiare dhe interesat e tjerë privatë të një rrethi të përcaktuar funksionarësh publikë dhe të personave të lidhur me ta. Ky qëllim përcaktohet qartë në nenet 1⁷³ dhe 30⁷⁴, përkatësisht të ligjeve nr. 9049/2003 dhe nr. 84/2016, ndër të tjera. Nën dritën e sa më sipër, argumenti i shumicës se subjekti i rivlerësimit nuk mban përgjegjësi/detyrim për deklarimin e veprimeve juridike dhe transaksioneve financiare të kryera nga personi i lidhur në aktivitetin e tij të biznesit⁷⁵, për sa kohë nuk rezultojnë të jetë deklaruar nga subjekti pasuri e gjeneruar nga këto aktivitete, përbën devijim nga zbatimi korrekt i ligjit dhe bie ndesh me logjikën ku bazohet deklarimi i pasurive apo vlerësimi i kriterit të pasurisë sipas ligjeve që rregullojnë këto dy aspekte. Në këtë kontekst, theksojmë se çdo pasuri në pronësi e përdorim nga subjekti, si dhe shpenzimet e konfirmuara të kryera prej tij dhe personave të lidhur, rezultojnë me probleme të ndryshme që karakterizohen nga mungesa e burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
13. Në arsyetimin tonë, sjellim në vëmendje që ligji nuk rezultojnë të ketë përjashtuar nga detyrimi për deklarim veprimet financiare apo ato juridike të kryera nga personat e lidhur në aktivitete të tyre të biznesit. Për më tepër, në funksion të objektivitetit dhe saktësisë së vlerësimit pasuror për subjektin, është me rëndësi fakti që personi juridik i themeluar, administruar dhe pronar i vetëm i të cilit, për 13 vjet të ekzistencës, ishte personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit]. Transaksionet e shtjelluara më sipër janë kryer dhe përfitimet vjelë nga personi i lidhur si individ, në llogarinë e tij bankare personale. Ky element përforcon më tej ndërthurjen mes veprimeve të personit të lidhur, të kryera prej tij në drejtim të përfitimeve financiare në aktivitetin privat, me

⁷³ Neni 1 i ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” përcakton që qëllimi i ligjit është: “[...] përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta”.

⁷⁴ Neni 30 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcakton që: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

⁷⁵ Shih paragrafin 23.2.10 të arsyesimit të shumicës, ndër të tjera.

pasojat e tyre në deklarin në kuadër të deklarimit periodik vjetor të pasurive dhe interesave, ashtu si edhe në kuadër të rivlerësimit. Në të kundërt – nëse pranohen të mirëqena pretendimet e subjektit se personi juridik i riaktivizuar në periudhën 2005-2018 nuk ka krijuar asnjë të ardhur dhe asnjë shpenzim – personi juridik shfaqet si një artific inekzistent. Në këto kushte, në një vlerësim të kujdesshëm të fakteve dhe rrethanave konkrete, mbivendosja e individit F. M. me personin juridik F. M. është e vetmja rrjedhë logjike në kushtet kur individi ka përfituar personalisht dhe ka marrë përgjegjësi [për zëvendësimin e kredisë] po personalisht. Në asnjë nga këto raste, fakti që personi i lidhur kishte marrë përsipër përgjegjësi dhe rënë dakord për të fituar të drejta, nuk u vu në dyshim nga rrethanat e faktit. Në këto kushte, zgjedhja e shumicës për të krijuar një dallim mes dy kategorive, përbën një devijim nga logjika e ngurtë e fakteve.

14. Nëse do të ndiqej logjika e ndarjes absolute mes detyrimeve si person juridik dhe atyre si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit/deklarues, procesi i deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe njëkohësisht edhe ai i rivlerësimit kalimtar, do të ishte vulnerabël dhe krejtësisht i paaftë të konstatonte edhe pasuri të fshehura nga subjektet nëpërmjet veprimtarive të biznesit të personave të lidhur, për sa kohë këta të fundit, në mënyrë konsistente, kryejnë evazion fiskal total, duke deklaruar humbje apo asnjë fitim nga veprimtari ekonomike aktive, qoftë edhe për dekada të tëra. Me fjalë të tjera, kjo mënyrë zbatimi e ligjit favorizon shkelje të rënda të kriterit të vlerësimit pasuror, ndërkohë që penalizon subjekte të cilat, në raport me ligjin dhe detyrimet fiskale, janë relativisht më të sinqerta apo të cilat janë shkarkuar për shkak se deklarimet e pasurive ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë [vetting] janë më të larta sesa ato të deklaruara përpara administratës tatimore, për të njëjtat veprimtari ekonomike. Kolegji tanimë ka jurisprudencë të konsoliduar, sipas së cilës subjektet janë gjetur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për shkak se personat e lidhur kanë rezultuar të deklarorin pasuri dhe të ardhura të cilat nuk përkonin me çfarë deklarohesh në administratën tatimore apo në fondin e sigurimeve shoqërore, në zbatim të konceptit të ligjshmërisë së të ardhurave dhe të konfirmimit të tyre nëpërmjet deklarimit dhe pagesës së tatimeve⁷⁶.
15. Për këtë arsye, vlerësojmë që subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për detyrimet e bashkëshortit dhe përfitimet nga aktiviteti privat. Përpos këtij fakti, theksojmë se problematikat e theksuara në aktivitetin e personit të lidhur janë të tilla që do të duhet të ishin vlerësuar nga trupi gjykues në drejtim të besimit që publiku duhet të gëzojë për magjistratët dhe drejtësinë.

II. Pamundësia financiare e huadhënësit

16. Votua kundër shumicës edhe në lidhje me këtë shkak ankimi, pasi analiza financiare e të ardhurave të dokumentuara me burime të ligjshme të huadhënësit kundrejt shpenzimeve, tregonte

⁷⁶ *Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit në çështjet që u përkasnin subjekteve të rivlerësimit A. Malaj [JR 27/2019], Xh. Zaganjori [JR 19/2019], Astrit Faqolli [JR 09/2019], Elision Sadiku [JR 07/2019], A. Sevdari [JR 06/2019] etj.*

pamundësi financiare për dhënien e huas prej 5.000 eurosh⁷⁷. Parë në mënyrë të ndërthurur me mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit për vlerën prej 4.000 eurosh, të pretenduar nga subjekti në gjendje *cash* në fund të vitit 2007 – konstatuar nga Komisioni gjatë hetimit – dhe në kushtet kur kjo shumë nuk ka asnjë gjurmë në deklaratimet periodike vjetore të vitit pararendës [2007], subjekti rezulton me një mungesë burimesh në vlerën (-) 1.094.925 lekë për të mundësuar pagesën e këstit të parë të apartamentit në vlerën 9.000 euro në 4 prill 2008. Subjekti rezulton me bilanc negativ në vitin 2007, gjë që nuk mundëson kursimin me burime të ligjshme të shumës së tërhequr në vitin 2007 dhe përdorur në vitin 2008, prej 312.472 lekësh [sipas paragrafit 9.5 të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi]. Për rrjedhojë, subjekti rezulton me pamundësi për ta krijuar shumën e kursimeve të pretenduara [4.000 euro] në periudhën kohore nga fillimi i vitit 2008 deri në ditën kur është kryer pagesa [4 prill 2008].

17. Qartazi, bilanci negativ i mësipërm përbën një mungesë të konsiderueshme në një vit kalendarik të vetëm në nivelin e pagave të magjistratëve në Republikën e Shqipërisë në vitet 2007-2008⁷⁸. Konkretisht, shuma prej 1.094.925 lekësh tejkalon totalin e pagesës vjetore të subjektit me thujse 20%, ndërsa kursimet e pretenduara dhe të padeklaruara prej tij në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, përbëjnë thujse 35% të pagës vjetore. Për sa më sipër, nën dritën e përlogaritjes së thjeshtë të vlerës së bilancit negativ, nuk ishim dakord me vlerësimin e shumicës se kjo shumë ishte e *pamjaftueshme* për t’u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm. Bilanci negativ i një viti të vetëm, në një vlerë që tejkalon të ardhurat vjetore të subjektit – për pjesën e këstit të pretenduar të mundësuar prej tij – përbën mungesë të burimeve të ligjshme dhe, për pasojë, do të duhej të ishte vlerësuar si deklarim i pamjaftueshëm për sa i përket krijimit të pasurisë apartament. Kjo mungesë përbën problem edhe më të spikatur për shkak të faktit që subjekti pretendon se të ardhurat e tij nga paga janë të vetmet të ardhura me të cilat është krijuar pasuria dhe janë përballuar gjithë shpenzimet familjare. Sjellim në vëmendje që, në një vështrim tërësor të mundësive financiare të subjektit të rivlerësimit për vitet 2003-2016⁷⁹, siç u parashtua në rekomandimin mbi bazën e të cilit u ushtua ankimi, do të rezultonte një diferencë negative më e thelluar.

III. Mosdeklarimi i detyrimeve financiare të personit të lidhur në zëvendësimin e debitorit

18. Votuar kundër shumicës në këtë shkak ankimi, pasi vlerësimi i shumicës, sipas të cilit u krijua “bindja” se subjekti i rivlerësimit “nuk ka pasur dijeni” për detyrimin e personit të lidhur, pavarësisht se mosdeklarimi bie ndesh me përgjegjësitë e tij sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk qëndron në dritën e akteve dhe analizës logjike të veprimeve të kryera nga

⁷⁷ Nga analiza financiare e personit të lidhur në cilësinë e huadhënësit, për vitet 2005-2008 rezulton me mundësinë financiare për të kursyer 470 euro. Nga ana tjetër, në gjendjen që janë aktet në fashikull, në këtë analizë nuk pasqyrohen investime të tjera që mund të jenë kryer nga familja e huadhënësit [A. Gj.], të cilat në analizë tërësore do të ndryshonin këtë mundësi për kursim në drejtim negativ.

⁷⁸ Për ilustrim, sjellim në vëmendje që pagesa vjetore e subjektit të rivlerësimit në vitin 2007, ishte afro 900.000 lekë, ndërsa në vitin 2008, ishte 890.000 lekë afërsisht.

⁷⁹ Shih pikën 5 të rekomandimit të ONM-së kundër vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit, sipas të cilit ankimi do të lejonte Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ndër të tjera të “[...] kryente një analizë të saktë financiare [...]”. Në ankimin e ushtuar mbi bazën e të njëjtit rekomandim, Komisioneri Publik nuk kërkoi kryerjen e një analize financiare.

subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Ndryshe nga shumica, vlerësojmë se, në analizë të fakteve dhe akteve në fashikull, subjekti nuk arriti të provojë asnjë nga pretendimet e tij për sa i përket kontestimit në rrugë gjyqësore të veprimeve procedurale, si pasojë e të cilave personi i lidhur ka marrë përsipër detyrim për zëvendësim të debitorit – nga ish-ortaku i tij në një nga bizneset e krijuara në vitet ‘90⁸⁰ – që, sipas tij, ka ndodhur në padijeni të personit të lidhur [bashkëshortit]. Subjekti po ashtu dështoi të provojë të kundërtën e fakteve të dëshmuara nga aktet në fashikull, të cilat provojnë që personi i lidhur ka vijuar të jetë deri në vitin 2018⁸¹ në aktivitetin biznesi me debitorin të cilin ka zëvendësuar. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi i Komisionerit Publik duhej të ishte pranuar.

19. Nga aktet në fashikull, rezulton që personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit] ka pasur dy procese civile në Gjykatën e Përmetit në vitin 2002. Si rrjedhojë, personi i lidhur ka lëshuar një prokurë përfaqësimi më 8 shkurt 2002 në emër të një avokati⁸² për përfaqësimin e tij në gjykatën e Përmetit. Data e prokurës është pak javë përpara vendimit të marrë nga gjykata për zëvendësimin e debitorit, “kundër” Agjencisë së Trajtimit të Kredive⁸³. Me vendimin e gjykatës, është pranuar kërkesa e paditësit, z. I., ndërsa z. F. M., personi i lidhur, është bërë zyrtarisht debitor kundrejt Agjencisë së Trajtimit të Kredive (në vijim “ATK”), në shumën prej 3.800.000 lekësh. Ky vendim rezulton të ketë hyrë në fuqi. ATK-ja referon që borxhi që i detyrohet personi i lidhur në datën 18.05.2020, ishte në vlerën 23.898.154 lekë, nga të cilat principali është në vlerën totale prej 5.310.000 lekësh⁸⁴.
20. Nga sa më sipër, del qartë që së pari, subjekti i rivlerësimit nuk provoi vijueshmërinë e veprimeve të kryera prej tij dhe personit të lidhur për të kontestuar vendimin e sipërcituar të gjykatës. Së dyti, tagra e përfaqësimit, dhënë nga personi i lidhur avokatit G. në dy çështje civile –gjithëpërfshirëse për padinë që lidhet me zëvendësimin e debitorit – tregon një marrëdhënie të qëndrueshme besimi dhe vlerësimi profesional, që përjashton logjikisht ndonjë pretendim për mungesë komunikimi apo keqbesimi potencial nga përfaqësuesi ligjor me prokurë. Për këto arsye, pretendimi për mungesë dijenie të fatit të zgjidhjes së çështjes nga gjykata, nga marsi 2002 deri minimalisht në momentin kur subjekti ka plotësuar deklaratën e pasurisë *vetting*, në janar 2017, duket aspak bindës.
21. Ky konkluzion logjik përforcohet në kushtet kur personi i lidhur konfirmohet nga aktet zyrtare⁸⁵ të ketë ruajtur marrëdhënie profesionale me palën kundërshtare/debitorin e zëvendësuar në kontestin civil [z. I.], duke qenë edhe bashkëpunëtor i tij në biznesin aktual. Në të njëjtën dritë, atë të mungesës së besueshmërisë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për padijeni të zëvendësimit të debitorit në vitin 2002, sjellim në vëmendje që rezulton e pakuptimtë se si papritmas, në shtator 2021 – gjatë procesit të rivlerësimit – subjekti rivlerësimit tregon njohuri për

⁸⁰ *Pikë karburanti në {***}, Përmet. Shih edhe poshtëshënimin nr. 14.*

⁸¹ *Shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 05.06.2020, me nr. prot. {***}, sipas së cilës personi i lidhur, z. F. M., figuron anëtar i bordit të menaxhimit në subjektin “{***}” ShA, me aksioner dhe administrator z. G. I.*

⁸² *Përpara noterit S. A., caktuar si përfaqësues të ligjshëm avokatin P. G., nr. {***} rep., nr. {***} kol. Nga prokura, rezulton që personi i lidhur ishte i përfshirë edhe në një proces tjetër gjyqësor civil, me palë kundërshtare Komuna {***} [Përmet], me objekt njohjen e pronësisë së një pike karburanti të ndodhur në fshatin {***}, me sipërfaqe truall 13.000 m².*

⁸³ *Ndërkohë, nga vendimi nr. {***}, datë 29.03.2002, i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, paditës është z. G. I., ndërsa i paditur është z. F. M.. Agjencia e Trajtimit të Kredive është personi i tretë.*

⁸⁴ *Referuar shkresës së dërguar nga ATK-ja Komisionit më datë 18.05.2020, nr. prot. {***}.*

⁸⁵ *Shih shkresën e cituar në poshtëshënimin nr. 13.*

ekzistencën e kallëzimit penal në ngarkim të z. I., të ushtruar në vitin 2010 nga ATK-ja⁸⁶, ashtu si është i pakuptimtë edhe argumentimi i tij që vendimi i gjykatës është i pavlefshëm apo që ATK-ja nuk e ka njohur atë [vendimin e gjykatës].

22. Në këtë kontekst, theksojmë që prokura e lëshuar nga personi i lidhur për përfaqësim të tij nga avokati G., në kontestin civil në Gjykatën e Përmetit, edhe për padinë me objekt zëvendësimin e debitorit, tregon që në kohën kur është hartuar kjo prokurë, subjekti/personi i lidhur e njëjtte autoritetin e gjykatës në procesin në fjalë. Pretendimet serioze të subjektit për pavlefshmëri të vendimit për shkak të mungesës së kompetencës lëndore, se gjykata ka “marrë cilësinë e noterit” – ngritur nga subjekti në Kolegj⁸⁷ – nuk rezultojnë të kenë ekzistuar në periudhën kur gjykata shqyrtonte padinë e z. I. dhe personi i lidhur autorizonte përfaqësuesin ligjor me prokurë në këtë gjykim.
23. Së dyti, në aktet e dërguara gjatë procesit të rivlerësimit, huaja e raportuar e personit të lidhur ka rezultuar ende e pashlyer. Edhe urdhri i ministrit të Financave i vitit 2002, në lidhje me problematikën e konstatuar⁸⁸ me këtë zëvendësim kredie, jo vetëm që nuk zhbën vendimin e gjykatës Përmet, me të cilin personi i lidhur ka marrë detyrimet nga zëvendësimi i kredisë, por krijon premisat për të konstatuar: (i) parregullsi të personit të lidhur në përgjigje të detyrimeve të tij të shumta; (ii) që prona e vendosur si garanci nga personi i lidhur për kredinë e përfituar, nuk është reale; dhe (ii) urdhëron përgjegjësi për ATK-në dhe marrje mase disiplinore nga funksionarë të kësaj të fundit. Është e pakuptimtë dhe jobindëse se si ndër vite, duke qenë subjekt deklarues i pasurive dhe interesave periodikë privatë, por edhe në funksion të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk tregoi asnjë interes për të qenë i mirinformuar për detyrimet financiare të personit të lidhur, në kushtet kur ai nuk rezultonte i punësuar dhe, ndonëse i angazhuar në aktivitete të ndryshme, kishte krijuar detyrime të konsiderueshme që në fillimet e aktivitetit të tij privat, që daton nga vitet '90.
24. Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësojmë që subjekti i rivlerësimit nuk ishte bindës për mungesën e dijenisë sa u përket fakteve që lidhen me zëvendësimin e kredisë. Mungesa e deklarimit do të duhej të ishte shoqëruar me pasojë në procesin e tij të rivlerësimit, parë në këndvështrim të besimit të publikut, minimalisht – në kushtet kur analiza financiare e rekomanduar të kryhej, nuk u përthith nga ankimi i Komisionerit Publik. Përkëto arsye, votuam për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 332, datë 12.01.2021, dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Lindita Male Ziguri, nga detyra.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

⁸⁶ Referuar kërkesës së subjektit të rivlerësimit për informacion ATK-së, me nr. prot. {***}, datë 23.09.2021, parashtruar në Kolegj nga subjekti në seancën e datës 20.10.2021.

⁸⁷ Faqe 8 dhe 9 e parashtrimeve në lidhje me shkaqet e ankimit, depozituar në datën 20.10.2021, në faqen 10 të kundërankimit, datë 23.04.2021, ndër të tjera.

⁸⁸ Parashtruar nga subjekti i rivlerësimit dhe marrë në cilësinë e provës gjatë seancës së datës 20.10.2021.